



RAPORTI I PUNËS DHE STATUTI I SHOQATËS

14 PRILL 2013 – 20 PRILL 2023

Gjenevë, 16 tetor 2023



RAPORTI I PUNËS DHE STATUTI I SHOQATËS
“KOMUNITETI SHQIPTAR I GJENEVËS”

14 PRILL 2013 – 20 PRILL 2023

H I S T O R I K U

Ideja fillestare për themelimin e shoqatës "Komuniteti Shqiptar i Gjenevës" ka rrjedhur nga pengesat shumëvjeçare për organizimin e festës sonë më të madhe kombëtare, Festës së Flamurit, Përvjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, Ditës së paraqitjes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ditëlindjes së Komandantit Legjendar të UÇK-së Adem Jashari, që të gjitha këto korrespondojnë me datën 28 nëntor. Pengesa këto, që lidheshin kryesisht, por jo vetëm, me mungesën e fondeve financiare. Por gjatë përpilimit të Statutit, apetiti për zgjerimin e aktiviteteve vinte duke u shtuar, sidomos duke konsultuar edhe statutet e shoqatave tjera simotra. Të gjitha aktivitetet të parapare me Statut, nuk janë konsoliduar as pas 10 viteve të ekzistencës së shoqatës. Megjithatë, asnjëherë më nuk kemi pasur probleme rreth organizimit të Festës. Urojmë që në të ardhmen aktivitetet e shoqatës të zgjerohen dhe thellohen nga gjeneratat që do vijnë.

Shoqata "Komuniteti Shqiptar i Gjenevës" është themeluar me 14 prill të vitit 2013, në Kuvendin themelues të mbajtur në sallën Cinéma-théâtre d'Onex-Parc në komunën Onex të Gjenevës. Me iniciativën e Ali Mehmetit, pas konsultimeve disa mujore, është formuar Këshilli iniciues në përbërje:

1. Ali Mehmeti, Leskocv, 1956, Fakulteti Elektroteknik – Prishtinë, pensionist AI, sekretar në Lidhjen e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptar në Gjenevë;
2. Ajet Hyseni, Mitrovicë, 1972, Fakulteti i shkencave politike – Gjenevë, Administrator i firmës Hyseni Construction;
3. Ardian Reka, Shkup, 1974, studioi Fakultetin Ekonomik – Prishtinë, Punëtor i sigurimit KS – Securite;
4. Arif Ejupi, 1959, Podujevë, Fakulteti Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Fakulteti Juridik – Prishtinë, pensionist AI;
5. Avdyl Gërvalla, 1955, Deqan, Fakulteti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze – Prishtinë, Përkthyes i pavarur;
6. Endri Veshi, 1978, Tiranë, Fakulteti i Menaxhimit – Gjenevë (HEG), Informaticien;
7. Erenik Yzeiraj, 1990, Elbasan, student ne HEC, Gjenevë, Shoqata e Studentëve Shqiptar të Gjenevës;
8. Fadil Avdija, 1967, Klinë, Fakulteti i Bujqësisë – Prishtinë, Laborant i biologjisë, Kryetar i Lidhjes së Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptar në Gjenevë;
9. Ismet Kurteshi, 1959, Gjilan, Fakulteti Juridik – Prishtinë, Mirëmbajtës i objektit;
10. Nebi Hyseni, 1964, Medvegjë, Shkolla e Mesme Ekonomike, pensionist AI;
11. Nexhat Xhymshiti, 1958, Gjilan, Shkolla e Mesme Ekonomike – Gjilan, Mbikëqyrës shkollë, Nënkryetar i FC Kosova;
12. Nexhmedin Ilazi, Ferizaj, Studioi në Fakultetin e Hotelierisë dhe Turizmit – Ohër, pensionist AI, Udhëheq Ansamblin "Gëzuar";
13. Skënder Svarqa, 1973, Ferizaj, Studioi në Fakultetin Ekonomik – Prishtinë, Pejsazhist, Anëtar i Kryesisë së UPSh-së.

Në Kuvendin themelues u prezantua Statuti i shoqatës dhe ueb sajt i shoqatës www.cageneve.ch të punuar nga Ali Mehmeti. Të dy dokumente u aprovuan, kurse u vendos që Këshilli iniciues të shndërrohet në Kryesi të shoqatës duke e plotësuar edhe me pesë anëtarë të rinj, të propozuar nga të pranishmit në sallë:

1. Afërdita Krasniqi, 1972, Prizren, Shkolla e Mesme Ekonomike, nëpunëse, anëtare shumëvjeçare në ShKA "Besa" Prizren dhe ShKA "Ilirët" Llozanë;
2. Lutfi Rexha, 1965, Ferizaj, Shkolla komerciale dhe CFC në Zvicër;
3. Lah Jashari, 1964, Smirë, (Viti), ShLP Ferizaj, pronar i firmës LSJ
4. Nasuf Nuhiu, 1975, Viti, Shkolla e mesme, nëpunës në sindikatën "Unia";
5. Agim Sherifi, 1971, Zhegër, (Gjilan) Shkolla komerciale, Inspektor i punës në Konferencën e Përbashkët për Metalurgji dhe Ndërtimtari në Gjenevë.



Ali Mehmeti




Ajet Hyseni



Ardian Reka



Arif Ejupi



Avdyl Gërvalla



Endri Veshi



Erenik Yzeiraj



Fadil Avdiija



Ismet Kurteshi



Nebi Hiseni



Nexhat
Xhymshiti



Nexhmedin
Ilazi



Skënder
Svarqa



Afërdita
Krasniqi



Nasuf Nuhii



Lah Jashari



Lutfi Rexha



Agim Sherifi

Në emër të Këshillit iniciues, z. Endri Veshi për Kryetar të shoqatës propozoi z. Ali Mehmeti, që u aprovuar njëzëri nga 96 pjesëmarrës në këtë Kuvend themelues. Më vonë, siç është e paraparë me Statutin, nga vet kryesia u zgjodhën për sekretar z. Ajet Hyseni dhe për arkëtar z. Nexhmedin Ilazi.

Viti i parë i ekzistencës së shoqatës është përcjell me një bujë të madhe, por të panevojshme, për shkak të qëndrimit tonë rreth një referendumi ku merreshin në mbrojtje gratë amvise (më shumë në raportin e punës).

Gjatë viteve ka pasur shumë lëvizje brenda kryesisë. Disa vinin dhe disa shkonin, secili për arsye të ndryshme, por megjithatë në fund është konsoliduar një bërthamë e cila ka mundësuar vazhdimësinë e punës së shoqatës.

Pas vitit të parë nga Kryesia janë tërhequr disa anëtarë për arsye të ndryshme, Ismet, Kurteshi, Erenik Yzeiraj dhe Ardian Reka kurse kryesisë i është bashkëngjitur z.Fadil Selmani sikur përfaqësues i shoqatës Medvegja.

Po ashtu sekretari Ajet Hyseni jep dorëheqje, për shkak të mungesës së kohës dhe obligimeve tjera. Për sekretar të ri, kryesia zgjodhi z.Fadil Selmanin.

Pas vitit të dytë janë larguar Nexhmedin Ilazi, Arif Ejupi, Avdyl Gërvalla dhe Endri Veshi, kurse nga kuvendi janë propozuar dhe zgjedhur anëtarët e rinj: Hekrem Maliqi, Lulëzim Sejdiu, Diellza Shatri dhe Musah Halili.

Ndërmjet dy kuvendeve nga pozita e arkëtarit është tërhequr z. Nexhmedin Ilazi dhe është zgjedhur z. Nasuf Nuhii.

Pas viti të tretë janë larguar Ajet Hyseni, Nexhat Xhymshiti dhe Djellza Shatri, kurse nga kuvendi janë propozuar dhe zgjedhur anëtarët e rinj: znj. Nerxhivane Ajvazi dhe z. Blerim Ibrahim.

Pas katër viteve, në kuvendin e pestë nga kryesia largohen Lulzim Sejdiu, Nerxhivane Ferati dhe Musah Halili, kurse është propozuar dhe pranuar Naser Islami sikur përfaqësues i shoqatës "Vitia".

Në këtë kuvend po ashtu është dashur të zgjidhet edhe kryetari i ri, pasi që Kryetarit aktual z. Ali Mehmeti i kishin skaduar dy mandate nga dy vjet, siç parasheh Statuti. Për kryetare është zgjedhur unanimisht znj. Afërdita Krasniqi, aktivistja e zellshme nga dita e parë të formimit të shoqatës sonë, por edhe më herret në shoqata tjera.

Në kuvendin e gjashtë, në vitin 2018, nga kryesia është tërhequr Skënder Svarqa, kurse është propozuar dhe pranuar znj. Arbërie Fejzi.

Dy vitet në vazhdim (janar 2019 – qershor 2021) ishin vitet e pasivitetit total për shkak të pandemisë të shkaktuar nga virusi covid-19. Për këtë arsye në kuvendin vijues që u mbajt në qershor të vitit 2022 u vendos që Kryetares aktuale t'i vazhdohet mandati edhe për dy vjet, për aq sa ajo nuk mundi ta ushtroj funksionin e vet.

Në këtë Kuvend nga kryesia u tërhoqën Lah Jashari dhe Arbërie Fejzi, kurse u propozuan dhe pranuan Rrezartë Sejdiu-Shatri, Linda Rexhaj-Maliqi, Blerim Bunjaku dhe Mergime Bajrami

Pra, në dhjet vjetorin e formimit të shoqatës, kryesia numëron 12 anëtarë, prej të cilëve vetëm tre janë nga këshilli iniciues, kurse gjysma janë nga përbërja e parë e saj dhe këta janë: Ali Mehmeti, Fadil Avdija, Nebi Hyseni, Afërdita Krasniqi, Lutfi Rexha dhe Nasuf Nuhii, kurse në përbërjen aktuale janë edhe: *Fadil Selmani, Blerim Ibrahim, Rrezartë Sejdiu-Shatri Mergime Bajrami, Linda Rexhaj-Maliqi dhe Blerim Bunjaku.*



Fadil Selmani

Blerim Ibrahim

Rrezartë Sejdiu-Shatri

Mergime Bajrami

Linda Rexhaj Maliqi

Blerim Bunjaku

Edhe njëherë u vërtetua fjala e urtë se "është më lehta ta bësh sesa ta mbash"!

Përkundër aktiviteteve të shumta kulturore, artistike, organizimit të shfaqjeve teatrale, koncerteve, filmave, konferencave me tematika të ndryshme, promovime librash, formimit të koralit "Hareja", ndihmave financiare të dhëna shoqatave tjera, sidomos LAPSh-së por edhe Shoqatës së Studentëve Shqiptar në Gjenevë, ende nuk mund dhe nuk duhet të jemi plotësisht të kënaqur, sepse Statuti ynë parasheh dhe kërkon edhe më shumë.

Kuptohet se për të gjitha këto aktivitete është dashur të sigurohen edhe mjetet financiare. Siç shihet nga pasqyra financiare, pjesa më e madhe vjen nga aktivitete tona të ndryshme, ku anëtarët e KShGj-së dhe shoqatave tjera me të cilat bashkëpunojmë, LAPSh, Gëzuar dhe Rinia Kontakt (periodikisht edhe me ca të tjera), të gjitha punët i bëjnë në mënyrë vullnetare dhe pa pagesë. Dy burime tjera janë pagesa e anëtarësisë dhe donacionet nga institucionet e ndryshme dhe ato private.

Përzemërsisht i falënderojmë të gjithë anëtarët dhe donatorët për bujarinë e tyre dhe shpresojmë që kjo traditë do vazhdon edhe më tutje.




Nëse dëshironi të përkrahni financiarisht ose të anëtarësoheni në Komunitetin Shqiptar të Gjenevës ju mund të bëni një donacion ose të paguani anëtarësinë duke përdorur shënimet e mëposhtme bankare.

Lartësia e anëtarësisë është përcaktuar nga Kuvendi Themelues dhe është 100 chf/vit për anëtar ose për familje.

Për familje me ndihma sociale, pensionistet dhe studentet që jetojnë vetëm, anëtarësia është 20f chf/vit.

Në shenjë falënderimi çdo donatorë do të shfaqet në sajtin tonë

Récépissé Compte / Payable à CH77 0900 0000 1276 3621 0 Communauté Albanaise de Genève Rue Croix-du-Levant 14 1220 Les Avanchets Payable par (nom/adresse) Monnaie Montant CHF Point de dépôt	Section paiement  Monnaie Montant CHF	Compte / Payable à CH77 0900 0000 1276 3621 0 Communauté Albanaise de Genève Rue Croix-du-Levant 14 1220 Les Avanchets Payable par (nom/adresse)
---	--	--

Communauté Albanaise de Genève

1220 Les Avanchets

IBAN CH77 0900 0000 1276 3621 0

Raporti financiar për periudhën 2013 - 2023

Lloji Viti	Të ardhura nga anëtarësia	Donacione nga institucionet	Donacione private	Sponsorizime	Manifestime	Gjithsej të ardhura	Shpenzime	Gjendja me 31.12.
2013	6 500	0	920	0	2 248	9 668	4 618	5 050
2014	4 500	¹ 6650	1 940	0	3 072	16 162	7 348	13 867
2015	5 100	² 1700	⁶ 4350	2 100	6 192	19 442	16 793	16 517
2016	4 180	³ 3000	0	1 400	7 393	15 973	15 569	16 921
2017	2 740	0	600	1 500	3 935	8 775	6 318	19 375
2018	2 880	⁴ 5000	530	0	4 434	12 844	11 275	20 947
2019	2 680	0	⁷ 1530	0	6 775	10 985	11 068	20 864
2020	320	0	530	0	4 034	4 884	3 421	22 327
2021	200	0	430	0	0	630	1 846	21 110
2022	1 820	⁵ 7700	⁸ 1350	0	2 055	12 925	5 087	28 948
shtator 2023	970	0	⁹ 2547	0	3 545	7 062	18 025	17 985
Gjithsej:	31 890	24 050	4 950	5 000	43 683	119 350	101 368	OK

¹ 6650 3400 fr nga Loterie Romand

² 1700 3250 fr nga Oeveria e Kosovës

³ 3000 1700 fr nga Ville de Geneve

⁴ 5000 3000 fr nga Loterie Romand

⁵ 7700 5000 fr nga Loterie Romande (janë kthyer donatorit për shkak të mosrealizimit të projektit)

⁶ 4350 7000 fr nga Loterie Romand

⁷ 1530 700 fr nga Ville de Vernier

⁸ 1350 3000 fr nga Shaban Selmani (Transporti "Creanit")

⁹ 2547 1000 fr nga Përpajrim Arifi (Kontabiliteti "Kouleta")

1000 fr nga Rami Morina (Cabinet dentaire Frontenex)

1000 fr nga Përpajrim Ajvazi (Shtypshkronja "BeePro")

1000 fr nga Besnik Benzi (Garazha "AutoPro")



RAPORTET E PUNËS NËPËR VITE




1. Konsolidimi administrativ

Punët administrative pas themelimit: Regjistrimi i shoqatës, hapja e xhiro llogarisë, marrja e adresës së shoqatës e cila nuk do ndryshohet sa herë ndryshon kryetari, punimi i sajtit www.cageneve.ch nga Ali Mehmeti, punimi i vulës së shoqatës, përgatitja e disa formularëve dhe gjera të ngjashme.



2. Reklama televizive “Mëso shqip”

Është puna e parë konkrete që është bërë në interes të mbarë mërgatës, je vetëm të neve në Gjenevë. Edhe pse kemi investuar vet, për ta emituar në RTK na u ka dashur intervenimi i ministrit të diasporës, pavarësisht që RTK ka obligim ligjor të emitoj falas çdo reklamë me interes publik.



Megjithatë kemi pasur shumë probleme gjatë transmetimit. RTK e ka filluar transmetimin, pas një jave e ka ndërprerë, prapë është dashur të intervenoj ministri vet, as kjo nuk ka mjaftuar, është dashur ta shkruajmë një letër të hapur, publike, nëpër gazeta që të bëjmë presion mbi RTK që të rifilloj transmetimi, dhe kur ka rifilluar nuk është transmetuar në kohën kryesore, por gjatë ditës dhe vonë në mbrëmje, kurse asnjëherë në kohën ndërmjet orës 19 – 20. Me një fjalë, mund të themi se është penguar transmetimi. Pse dhe nga kush, nuk mund të themi.

3. Festa e Flamurit dhe 101 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë

Kjo festë është organizuar në bashkëpunim edhe me shoqata tjera shqiptare të Gjenevës, kurse është zhvilluar në sallën Palladium.





Shoqata jonë ka organizuar bufenë, nga ku janë fituar mbi 1700fr të cilat sipas marrëveshjes me shoqata tjera do të përdoren për festën e vitit 2014.





Veçoria e kësaj feste në krahasim me vitet tjera ka qenë se këtë vit para publikut janë prezantuar të gjithë, të posa diplomuarit studentë shqiptar në studimet master nga Universiteti i Gjenevës ose Llozanës, por që janë nga Gjeneva.



Po ashtu këtyre studentëve iu janë ndarë edhe mirënjohjet në emër të përmirësimit të imazhit të komunitetit tonë në Gjenevë dhe mbarë Zvicrën. Ky detaj ka hasur në interesim të madh të publikut dhe këtë praktikë do ta vazhdojmë edhe viteve tjera. Ajo që na është paraqitur si problem është gjetja e këtyre studentëve dhe ardhja e tyre në manifestim. Pra, në këtë pikë presim bashkëpunim më të gjerë.

4. Promovim librash

Gjatë kësaj periudhe janë bërë edhe dy promovime librash në bashkëpunim me vet autorët apo shoqatat që kanë qenë të përfshira. Është bërë promovimi i librit "Shqiptarët në Zvicër - 1001 pamje" të autorit Rexhep Rifati dhe monografia "30 vjet në shërbim të kombit" të shoqatës "Medvegja".



5. Ligjëratat e Daut Demakut

Kjo ligjëratë është realizuar në bashkëpunim me Shoqatën e Studentëve Shqiptar në

Gjenevë në ambientet e Universitetit të Gjenevës. Ligjëratë mbi mendimin pozitiv dhe mbi nevojën e barazisë së femrës në familje dhe në shoqëri, të cilën e mbajti prof. Daut Demaku nga Universiteti i Prishtinës.



Me këtë rast është shënuar edhe 25 vjetori i grevës së minororëve të Trepçës nga viti 1989, sikurse edhe dita ndërkombëtare e gjuhës amtare.

6. Mësimi mbështetës, autorizimet, tuneli

Në fillim të këtij viti kemi arritur të ofrojmë edhe disa shërbime shumë praktike për komunitetin:

a) Me iniciativën e një grupi të vajzave, e këto janë Diellza Avdia, Valmire Iseni, Yilka Kurteshi, Miranda Ismajli, Besarta Iseni dhe Sadie Avdija është propozuar që të organizohet mësimi mbështetës për nxënës që kanë nevojë, me një çmim preferencial, kurse gjysma e mjeteve të mbledhura do t'i dhurohet ndonjë organizate që merret me problemet e grave të dhunuara në Kosovë gjatë luftës së fundit;

 Komuniteti Shqiptar Gjenevë Association des Albanais de Genève www.cageneve.ch		PA IDENTITET NUK KA DINJITET AS DIVERSITET		 Komuniteti Shqiptar Gjenevë Communauté Albanaise Genève		PA IDENTITET NUK KA DINJITET AS DIVERSITET	
Mësimi mbështetës Me propozimin e një grupi të vajzave, ndodhur të shkëlqyera të shkollave të Gjenevës, dhe me mbështetjen e Komunitetit Shqiptar të Gjenevës, është organizuar mbajtja e mbështetjes në ato klasa dhe për ata nxënës që kanë nevojë për mbështetje. Për sa që gjatë, për nxënës, nga në klasën e 11 të është të orientuar, për datën më organizuar në ndërkombëtare të shkollave të mesme.		DONATORËT Intertours MoneyGross		Autorizimi Shumë herë kemi nevojë të huazojmë veturën nga një shoq, mik apo familjar. Për të shfrytëzuar me makinë të huazuar, kemi nevojë të kemi autorizimin nga prorit i veturës. Sidoqoftë, autorizimi, kur shfrytëzohet janë zonës Schengen, ku ndahet rastet kur janë të obliguar. Ky është rasti kur shfrytëzohet për vendlindje këtu këtu, Mal të Zi, Serbi, Shqipëri, Greqi dhe Hungari. Komuniteti Shqiptar i Gjenevës ka përgatitur një autorizim të tillë në 5 gjuhë.		DONATORËT Intertours MoneyGross	
Nëse jeni prind dhe dëshironi që fëmija juaj të ndërtojë gjatë mësimit, mësimi të jetë praktikë, dhe në informuar se në cilën klasë është fëmija juaj, për cilin fëmijë jeni të interesuar, ku bazoni dhe shfaqni specifikat tjerë të nevojës. Paga për ta bërë direkt mbledhjet që mëson fëmijën tuaj, pasi që...		intertours 022 510 10 12		MoneyGross 022 510 10 12		intertours 022 510 10 12	
7. Masivizimi Tani për tani, sfida jonë kryesore është masivizimi. Për një vit kemi arritur të bëhemi rreth 100 anëtarë, respektivisht familje, pra mund të themi se kemi disa qindra anëtarë. Megjithatë, ky numër nuk është në përputhje me përpjekjet që kemi bërë. Në muajin maj 2013 kemi dërguar rreth 300 letra me fletëregjistrime në adresa të ndërmarrjeve me pronarë shqiptarë në Gjenevë, kurse në muajt nëntor - dhjetor 2013 janë dërguar edhe 900 letra të tjera në adresa të familjeve shqiptarë në Gjenevë. Sipas rezultateve, mund të konstatojmë se e gjitha është treguar si gabim, si humbje kohe dhe harxhim parash, pasi që nuk kemi arritur të risim dukshëm		MoneyGross 022 510 10 12		intertours 022 510 10 12		intertours 022 510 10 12	

b) Është përpiluar një autorizim universal për përdorimin e veturave që nuk janë në emër tonin, kurse mund ta shfrytëzojnë falas të gjithë ata që kanë nevojë dhe që janë anëtarë të komunitetit;

c) Shfrytëzimi i biletave për shumë kalime të tunelit Mont Blanc nga më shumë përdorues. Një kalim kushton 42 euro, kurse nëse shfrytëzojmë kartën për 10 kalime, një kalim kushton 14 euro. Nëse e shfrytëzojmë në dy drejtime, kursimi është 56 euro.

7. Masivizimi

Tani për tani, sfida jonë kryesore është masivizimi. Për një vit kemi arritur të bëhemi rreth 100 anëtarë, respektivisht familje, pra mund të themi se kemi disa qindra anëtarë. Megjithatë, ky numër nuk është në përputhje me përpjekjet që kemi bërë. Në muajin maj 2013 kemi dërguar rreth 300 letra me fletëregjistrime në adresa të ndërmarrjeve me pronarë shqiptarë në Gjenevë, kurse në muajt nëntor - dhjetor 2013 janë dërguar edhe 900 letra të tjera në adresa të familjeve shqiptarë në Gjenevë. Sipas rezultateve, mund të konstatojmë se e gjitha është treguar si gabim, si humbje kohe dhe harxhim parash, pasi që nuk kemi arritur të risim dukshëm



numrin e anëtarëve. Si e vetmja mënyrë efikase është treguar biseda me çdo njeri veç e veç. Pra, mbetet si detyrë kryesore e çdo anëtari të punoj në këtë drejtim. Dy mënyra janë për t'u bërë të dobishëm për komunitetin tonë: të kemi fonde të mjaftueshme ose të jemi shumë anëtarë. Shumë anëtarë do të thotë shumë ide, shumë mundësi për ofrimin e shërbimeve të ndryshme, kurse shumë para do të thotë mundësi për shumë aktivitete dhe shumë shërbime të cilat mund të kërkohen edhe nga të tjerët, jashtë komunitetit.

Tentimi ynë për të marrë pjesë aktive në çështje që prekin interesin e të gjithëve, para së gjithash nënave që kujdesen për fëmijët e tyre në shtëpi, sepse të tilla janë shumica e nënave shqiptare, hasi në një rezistencë e cila vështirë të shpjegohet dhe përcaktohet nga erdhja?! Kjo ndodhi pas pozicionimit tonë rreth një çështjeje për të cilën votohej në referendum.

Kryetar
Ali Mehmeti

Më poshtë, është letra e hapur dërguar disa institucioneve të Republikës së Kosovës në lidhje me (mos)emitimin e spotit në RTK për sensibilizimin e prindërve që të dërgojnë fëmijët e tyre në mësimin plotësues të gjuhës shqipe. Po ashtu edhe deklarata jonë për opinion rreth çështje së referendumit që çoi aq pluhur të panevojshëm.



Communauté Albanaise – Genève
Komuniteti Shqiptar - Gjenevë
1220 LES AVANCHETS (GE)
e-mail : cageneve@gmail.com
web : www.cageneve.ch



21 shtator 2013

LETËR E HAPUR

- Para se kjo letër të bëhet e hapur i është dërguar më poshtë të emëruarve me 16 shtator 2013 -

Presidentes, znj. Atifete Jahajaga
Kryeministrit, z. Hashim Thaqi
Ministrit të arsimit, z. Ramë Buja
Ministrit të diasporës, z. Ibrahim Makolli
Ministrit të punëve të jashtme, z. Enver Hoxhaj
Të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës

Të nderuar përfaqësues të popullit,

Duke e ditur se nuk keni shumë kohë për ta lexuar këtë letër, do t'ju informoj në mënyrë telegrafike për sa vijon:

1. Komuniteti Shqiptar i Gjenevës ka financuar dhe prodhuar një reklamë, që do të sensibilizonte prindërit shqiptar në diasporë t'i dërgojnë fëmijët e tyre të mësojnë gjuhën shqipe nëpër kurse të mësimit plotësues të gjuhës shqipe, që organizohen në diasporë nga Lidhja e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptar "Naim Frashëri";
2. Në marrëveshje me ministrin e diasporës z. Ibrahim Makolli kjo reklamë është dashur të transmetohet në RTK nga fundi i muajit gusht gjer në fund të muajit shtator, pra në kohën kur edhe bëhet regjistrimi nëpër shkolla;
3. Transmetimi i reklamës ka filluar nga 22 gushti 2013 gjer më 30 gusht dhe pastaj është ndërprerë pa asnjë sqarim;
4. Pas intervenimit të z. Makolli, pas një jave transmetimi ka rifilluar, por prapë pas një jave është ndërprerë dhe më nuk është transmetuar gjer në ditën e sotme.

Duke e ditur se RTK është transmetues publik dhe se transmetimi i kësaj reklame nuk është çështje private, por pikërisht me interes publik, edhe sipas rregullores së tyre janë të obliguar të transmetojnë reklama të tilla, ju lutemi të ndërmerrni masa adekuate që kjo reklamë të rifillojë të transmetohet urgjentisht, sepse pas disa javësh e humb efektin. Apo e keni humbur kontrollin mbi RTK-në?

Ju lutemi të tregoni minimumin e respektit për përpjekjet titanike të mërgatës për rruajtjen e gjuhës shqipe dhe mos të na shikoni vetëm nëpërmjet dërgesave monetare, sepse me humbjen e gjuhës do humbisni edhe dërgesat.

Përhëndetje të sinqerta.

Kryetar
Ali Mehmeti

P.S.

Spotin mund ta shihni në këto dy lidhje:

<http://www.cageneve.ch/>

<https://www.youtube.com/watch?v=5wufK4aFgeQ>



Communauté Albanaise – Genève
 Komuniteti Shqiptar - Gjenezë
 1220 LES AVANCHETS (GE)
 e-mail : cageneve@gmail.com
 web : www.cageneve.ch

KOMUNITETI SHQIPTAR I GJENEVËS: SQARON OPINIONIN PUBLIK

"Albinfo", një portal në internet, që audiencë ka kryesisht diasporën shqiptare të Zvicrës, më 10 nëntor 2013 botoi shkrimin me titull "A po politizohet Komuniteti Shqiptar i Gjenezës?" Po ashtu "Tribune de Genève" e datës 22 nëntor 2013 e publikoi shkrimin e gazetarit Eric Burdry me mbishkrim "Iniciativa e UDC-së shkakton grindje tek Shqiptarët" ("L'initiative UDC sème la zizanie chez les Albanais"). Të dy këto shkrime, përcillnin disa opinione në lidhje me pozicionimin e Komunitetit Shqiptar të Gjenezës për referendumin e 24 nëntorit 2013.

Gjenezë

A po politizohet "Komuniteti Shqiptar i Gjenezës"?

10.11.2013 - 09:46

Thirrja e "Komunitetit Shqiptar të Gjenezës" lidhur me një çështje për të cilën votohet në një referendum në nivel të Zvicrës, ka ngjallur reagime nga shoqatat simotra në Gjenezë dhe nga Kuvendi Shqiptar në Zvicër.

Komuniteti Shqiptar i Gjenezës
 Communauté Albanaise Genève

PA IDENTITET
 NUK KA DINJITET
 AS DIVERSITET



L'initiative UDC sème la zizanie chez les Albanais

L'association Communauté albanaise soutient officiellement l'initiative «Pour les familles». Colère d'albanophones

Eric Burdry

Après les albanophobes de Suisse et l'UDC, ce n'est pas seulement le grand amour. Particulièrement en Suisse alémanique, où la communauté albanaise a été violemment attaquée lors de campagnes de recrutement. Ainsi, Eric Burdry dans les pages de position de la brochure officielle genevoise sur le referendum de la Communauté albanaise.



Për hir të opinionit sqarojmë, që Komuniteti Shqiptar i Gjenezës, si Shoqatë e themeluar muaj më parë nuk ka pretendime që qytetarit t'ia imponoi kurrfarë diktati përkritazi me shprehjen e vullnetit të tij të lirë. Duke u nisur nga parimi që referendumi është një e drejtë themelore dhe e barabartët për të gjithë, Komuniteti ynë u përcaktua në lidhje me dy iniciativa që kishin te bënin jo vetëm me interesin tonë, por edhe të qytetareve tjerë. Etiketimi ynë nga disa individë se kinse ne jemi pozicionuar përkrah UDC-se ishte i nxitu(a)r, i paqëndrueshëm dhe dashakeq.

A s'është absurd fakti që u kursyem nga akuzat në rastin e pozicionimit tonë kundër ngritjes së taksës për shfrytëzim të autostradës? Këtë pikë kritikët tanë e miratuan në heshitje, ngase edhe ata donin që të kursenin xhepin e tyre, pa u interesuar fare që iniciativa vinte nga UDC-ja. Reagimet ndaj Komunitetit tonë gjetën pretext piken dy të referendumit, ku parashihej barazia fiskale e familjeve me fëmijë në çerdhe dhe të atyre që vet kujdesen për ta, ashtu siç ishte deri në vitin 2011. Kjo pikë u shqyrtua me shumë kujdes nga Komuniteti ynë dhe erdhëm në përfundim se pozita aktuale e nënave me fëmijë të vegjël është e atille, që kërkonte mbështetjen tonë. Ndërkaq për piken 1 Komuniteti Shqiptar u tregua asnjansë.

Atëherë ku u gjend e drejta për akuzë se gjëja ne si Komuniteti Shqiptar i Gjenezës qenkemi mbështetës të UDC-se?

T'u thuash "JO" çështjeve konkrete, ashtu siç u tha pjesa dërmuese e popullit të Zvicrës në referendumin e javës së kaluar, nuk është fare e rëndësishme se a je pjese apo jo e ndonjë partie. Iniciativat si këto, i percepton dhe i vlerëson populli pa qenë i kycur nëpër parti. Ne, thjesht u keqinterpretuam qëllimisht, sepse nuk bëmë pozicionim partiak, por vetëm realizuam një të drejtë sikurse pjesa tjetër e qytetareve të Zvicrës.

Në vijim po ofrojmë disa të dhëna statistikore që nxjerrin në shesh të vërtetën. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2011, kur pjesëmarrja ishte 49,1%¹⁾, UDC në nivel vendi

pati fituar 26,6%¹⁾ të votave, ose afër 650 mijë vota²⁾. Ndërkaq iniciativa e UDC-së në referendumin e fundit, kur pjesëmarrja ishte 52,8%³⁾, u votua nga shumë më tepër votues. Pika dy u përkrah nga 41,5%³⁾ të votuesve, ose me 1,14 milion vota³⁾, kurse pika tre u votua edhe më fuqishëm, nga 60,5%³⁾ votues, ose thënë ndryshe pati rreth 1,66 milion përkrahës³⁾. Nga zbërthimi i këtyre përqindjeve del se, më tepër kanë votuar për iniciativën e UDC-se zgjedhësit e partive tjera dhe ata që janë fare të pa parti, se sa vet elektorati i UDC-se. A nuk është ky edhe një argument që flet, kur janë në pyetje problemet e përgjithshme të shtruara me referendum, vije në shprehje vota e popullit që shpreh interesin e tyre, pavarësisht se nga cila parti dalin iniciativat. Dhe se kjo votë dukshëm dallon nga ajo gjatë zgjedhjeve elektorale, të cilat shprehin vullnetin politik, respektivisht partiak, duke vendosur mbi shpërndarjen e pushtetit ndërmjet partive.

Mendojmë që pluhuri i çuar ishte i panevojshëm ngaqë populli nëpërmjet referendumit e tha fjalën e tij dhe kështu përfundimisht shleu çdo hamendje dhe paragjykim.

Qëndrim primar i Komunitetit Shqiptar te Gjenevës, ishte dhe mbetet interesi i përgjithshëm shoqëror dhe në veçanti i komunitetit shqiptar, ashtu si ne e shohim, dhe në asnjë mënyrë ai klanor apo individual. Garanci për këtë është Statuti ynë dhe transparenca e plotë, duke filluar nga numri i anëtarëve, raportet e punës, gjendjes financiare, verifikuesit e kontos e tjera.

Asnjëherë kjo Shoqatë nuk ka shfaqur tendencë dhe as që ka mëtuar përfaqësimin e shqiptarëve të Gjenevës si tërësi.

Ambiciet dhe synimet e të tjerëve për këtë përfaqësim, të adresuara në emër të tjetërkujt, nuk janë të justifikueshme.

Sidoqoftë, Komuniteti Shqiptar i Gjenevës shpreh gatishmërinë për bashkëpunim me të gjitha institucionet e Gjenevës dhe shoqatat e klubet si motra ne Zvicër dhe jashtë saj, duke pasur kriter bashkëpunimin e ndërsjellë dhe korrekt pa ndërkëmbje e njollosje të njeri-tjetrit.

Gjenevë, më 29.11.2013

Kryesia e Komunitetit Shqiptar – Gjenevë
Kryetar – Ali Mehmeti



Burimi i të dhënave:

¹⁾ <http://www.parlament.ch/f/wahlen-abstimmungen/parlamentswahlen/wahlen-2011/Pages/eckdaten.aspx>

²⁾ <http://www.atlas.bfs.admin.ch/core/projects/12/fr-fr/viewer.htm?12.0.fr>

³⁾ <http://www.parlament.ch/f/WAHLEN-ABSTIMMUNGEN/VOLKSABSTIMMUNGEN/VOLKSABSTIMMUNGEN-2013/ABSTIMMUNG-2013-11-24/Pages/default.aspx>



1. Misioni i informimit

Komuniteti Shqiptar i Gjenevës është shndërruar në një mjet të fuqishëm për informimin e bashkëkombësve tanë në Gjenevë rreth ngjarjeve të ndryshme, ato kulturore dhe sportive sidomos. Kjo bëhet nëpërmjet postës elektronike meqenëse disponojmë me disa qindra adresa, sikurse edhe me sajtin tonë në internet.



Gjatë kësaj periudhe janë bërë shumë shpallje me kërkesë të shoqatave të ndryshme: Klubit të futbollit FC Kosova për turnir futbollit, Rrethit shqiptar-mejrinas për një mbrëmje poetike, Shoqatës së Studentëve Shqiptar nga Llozana për një ligjëratë nga shkrimtari Kim Mehmeti, Shoqata Zhegra për "Ditët e Agim Ramadani, Shoqata e Muhaxhirëve të Kosovës dhe Preshevës për shfaqjen e dokumentarit "Molla e kuqe" dhe shumë të tjera.

2. Dita ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore

Me financimin tonë, në bashkëpunim me znj. Mira Bregu nga ambasada e Shqipërisë, më 10 tetor 2014 kemi shënuar Ditën ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore. Kjo është bërë me një koncert ku morën pjesë shumë artistë nga Kosova dhe Shqipëria: aktorë, këngëtarë, instrumentistë dhe valltarë që vinin nga Gjeneva, Nyoni, Llozana dhe Cyrihu. Koncerti u mbajt në Salle de Faubourg në Gjenevë, hyrja ishte falas, kurse ishin rreth 300 shikues.



3. Ligjëratë mbi identitetin e shumëfishtë

Në bashkëpunim me Shoqatën e studentëve shqiptar nga Gjeneva është organizuar një ligjëratë mbi identitetin e shumëfishtë të të rinjve të gjeneratës së dytë me

origjinë të huaj. Këtë ligjëratë e mbajtën dy doktorë të shkencave të sociologjisë. Dr.sc. Rifat Haxhijaj dhe Dr.sc. Claudio Bolzman, profesor në Shkollën e lartë për punë sociale në Gjenevë. Ligjëratat u mbajt në njërën nga sallat e Universitetit të Gjenevës para rreth 150 të pranishmëve.



4. Festa e Flamurit dhe 102 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë

Festa e Flamurit këtë vit është shënuar me pjesëmarrjen masive, si për nga numri i ansambleve ashtu edhe për nga numri i publikut. Ansamblet ishin nga disa qytete të Zvicrës: Berna, Llozana, Arau, Gjeneva, St. Julien. Festimi u mbajt me përkrahjen financiare të Ministrisë së Diasporës së Kosovës dhe në bashkëpunim me Lidhjen e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptar, Rinia kontakt dhe Rrethin Shqiptar-Mejrinas.



Në këtë mbrëmje është bërë edhe prezantimi i studentëve shqiptar nga Gjeneva, të posa diplomuar në nivelin master nëpër Universitete zvicerane të cilëve iu nda nga një mirënjohje për përmasimin e imazhit tonë në Gjenevë dhe Zvicër.



Edhe më tutje mbetet problem gjetja e këtyre studentëve dhe ardhja e tyre në

manifestim. Pra, në këtë pikë presim bashkëpunim më të gjerë.

5. Shfaqja teatrale “Z. Ibrahim dhe Lulet e Kuranit”

Kulmi i aktiviteteve për këtë periudhë ishte shfaqja e monodramës “Z. Ibrahim dhe Lulet e Kuranit” në interpretimin e Aktorit tonë të madh, Mjeshtrit të skenës dhe Nderit të kombit z. Mirush Kabashi. Shfaqja u zhvillua në Teatrin Madeleine në Gjenevë me 24 janar 2015.



Përveç angazhimit tonë disamujor dhe pjesëmarrjes financiare, kjo u mundësua edhe nga donacioni që iu akordua shoqatës tonë nga Ville de Geneve dhe nga Loterie Romand në shumë prej 1'700, respektivisht 3'400 fr. Shfaqja ishte mjaft e vizituar, me mbi 300 shikues. Çmimi i biletës ishte më shumë simbolik (10CHF). Kjo ngjarje u shënua nga dhjetëra mjete të informimit masiv, gazeta dhe televizione në Shqipëri, Kosovë dhe Zvicër, të pasuara edhe me disa intervista të Mirush Kabashit nëpër televizionet e Shqipërisë, ku shpreh falënderim të thellë për mikpritje dhe organizim të shfaqjes në një teatër prestigjioz.

6. Vizita e Tinka Kurtit

Në bashkëpunim me znj. Mira Bregu, artiste dhe ish diplomate e shtetit shqiptar kemi organizuar ardhjen e znj. Tinka Kurti, Artiste e popullit dhe Nderi i kombit në Gjenevë. Ndihmën e vet e dha edhe bashkëkombësi ynë z. Aziz Kosmani, duke ofruar lokalin e tij pa pagesë për zhvillimin e programit. Kjo u bë me rastin e Ditës së Gruas, 8 Marsit.



Aktorja jone e madhe rrëfeu për takimin e saj me nobelisten shqiptare Nënë Terezën, vargjet e të cilës edhe na recitoi, në mesin e vargjeve të tjera.

E gjitha përfundoi me një koktej rasti, muzikë dhe shkëmbim idesh mes të pranishmëve.



7. Prezantimi i kandidatëve për zgjedhjet komunale dhe udhëzimet për mënyrat e votimit

Me 29 mars 2015 është organizuar një tubim me bashkatdhetar me rastin e zgjedhjeve komunale në Gjenevë. Kësaj radhe kanë qenë 19 kandidatë shqiptar për asamblatë e ndryshme komunale në kantonin e Gjenevës. Kanë qenë të ftuar të gjithë kandidatët pavarësisht përkatësive partiake. Kështu KShGj ka dashur ta shprehte neutralitetin e vet ndaj partive politike. Tubimi është organizuar për dy qëllime: të paraqitet një udhëzim se si mund të shprehet vullneti politik në mënyrë më të përshtatshme dhe të prezantohen kandidatët para publikut. Për qëllimin e parë është përgatitur një dokument në PowerPoint ku deri në detaje janë paraqitur teknikat e votimit dhe janë prezantuar para publikut. Po ashtu një video udhëzim që ishte i përgatitur nga Zyra për integrimin e të huajve në kantonin e Gjenevës është përkthyer dhe përshtatur në shqip.

Komuniteti Shqiptar
Gjenevë
Communauté Albanaise
Genève

**PA IDENTITET
NUK KA DINJITET
AS DIVERSITET**

1. Kush ka drejtë vote dhe si votohet?
2. Prezantimi i kandidatëve.

Në Gjenevë, më 29 mars 2015 ueb: www.cageneve.ch e-posta: cageneve@gmail.com



Të dyja këto dokumente janë publikuar edhe në sajtin tonë ku janë bërë të arritshme edhe për publikun më të gjerë dhe mund të shërbejnë edhe herëve tjera.

8. Përkrahja e shoqatave tjera

Gjatë kësaj kohe jemi përpjekur të ndihmojmë edhe shoqatat tjera të cilat japin kontribut në ruajtjen e identitetit tonë kombëtar. Shoqata "Gëzuar" është përkrahur me 500fr me rastin e pjesëmarrjes së tyre në festimin e 50 vjetorit të ansambllit "Shota" në Prishtinë, kurse grupi "Rapsodët" është përkrahur me 500fr me rastin e pjesëmarrjes së tyre në Festivalin folklorik mbarëkombëtar në Gjirokastrë.

Kryetar
Ali Mehmeti

1. Misioni i informimit

Komuniteti Shqiptar i Gjenezës edhe më tutje mbetet një mjet i fuqishëm për informimin e bashkëkombësve tanë në Gjenezë rreth ngjarjeve të ndryshme, ato kulturore, sportive, në rastin e vdekjeve të bashkatdhetarëve tanë, madje edhe për ngjarje politike: në rastin e zgjedhjeve për nivelet e ndryshme të pushtetit apo kur shtrihen pyetjet e ndryshme në formë të referendumit. Kjo bëhet nëpërmjet postës elektronike meqenëse disponojmë me disa qindra adresa, sikurse edhe me sajtin tonë në internet. Na vazhdim, disa nga shpalljet dhe aktivitetet tona.



NJOFTIM
Këshilli Organizativ "Ditët e Agimit 2015"
Organizojnë
MANIFESTIMIN TRADICIONAL KULTUROR "DITËT E AGIMIT" GJENEVË
Manifestimi do të mbahet më datën 17 Maj të vitit 2015. Qasuror në Bulevaren e Komunitetit të Gjenezës.
Nga ora 12:00
Mënyrë organizimi: Niveli i agimit, shfaqje tradicionale të Shqipërisë, "Aja e Mëdha", Fjalë të shprehjeve të Agimitit.
Për më shumë informata kontaktoni:
Djalë Laci
Arbën Basha
Rena Gjergji
Mënyrë organizimi: Niveli i agimit, shfaqje tradicionale të Shqipërisë, "Aja e Mëdha", Fjalë të shprehjeve të Agimitit.
Mënyrë organizimi: Niveli i agimit, shfaqje tradicionale të Shqipërisë, "Aja e Mëdha", Fjalë të shprehjeve të Agimitit.
Mënyrë organizimi: Niveli i agimit, shfaqje tradicionale të Shqipërisë, "Aja e Mëdha", Fjalë të shprehjeve të Agimitit.
Mënyrë organizimi: Niveli i agimit, shfaqje tradicionale të Shqipërisë, "Aja e Mëdha", Fjalë të shprehjeve të Agimitit.
Kontakt: 078 882 88 88 / 078 882 88 88



TRIBUNË PËR PROJEKTET
Tribuna për Projektet është një platformë e re për diskutimin e projekteve të reja të bashkëkombësve tanë në Gjenezë. Tribuna do të mbahet më datën 14 Qershor 2015. Qasuror në Bulevaren e Komunitetit të Gjenezës.
Nga ora 18:00
Mënyrë organizimi: Niveli i agimit, shfaqje tradicionale të Shqipërisë, "Aja e Mëdha", Fjalë të shprehjeve të Agimitit.
Për më shumë informata kontaktoni:
Djalë Laci
Arbën Basha
Rena Gjergji
Mënyrë organizimi: Niveli i agimit, shfaqje tradicionale të Shqipërisë, "Aja e Mëdha", Fjalë të shprehjeve të Agimitit.
Kontakt: 078 882 88 88 / 078 882 88 88



Turnir në futboll të vogël 5+1
FC Kosova GJ
Çmimet për Fitues:
Të parët: 300
Të dytët: 200
Të tretët: 100
Kujtimori për pjesëmarrësit: 750
Kujtimori për fituesit: 1500
Mënyrë organizimi: Niveli i agimit, shfaqje tradicionale të Shqipërisë, "Aja e Mëdha", Fjalë të shprehjeve të Agimitit.
Kontakt: 078 882 88 88 / 078 882 88 88



Prezantim i librit dhe bashkëbisedim me autorin Bardhyl Mahmuti
Bardhyl Mahmuti
Mënyrë organizimi: Niveli i agimit, shfaqje tradicionale të Shqipërisë, "Aja e Mëdha", Fjalë të shprehjeve të Agimitit.
Kontakt: 078 882 88 88 / 078 882 88 88



EXPÉDITION VERS L'INCONNU
Mënyrë organizimi: Niveli i agimit, shfaqje tradicionale të Shqipërisë, "Aja e Mëdha", Fjalë të shprehjeve të Agimitit.
Kontakt: 078 882 88 88 / 078 882 88 88



VIERGE SOUS SERMENT
Mënyrë organizimi: Niveli i agimit, shfaqje tradicionale të Shqipërisë, "Aja e Mëdha", Fjalë të shprehjeve të Agimitit.
Kontakt: 078 882 88 88 / 078 882 88 88



Nga Camëria në Sarxhak Shqipëria tjetër
15 PRILL 2016
UNI MAIL SALLA #15 150
BOULEVARDI DË RONT D'ARVE 40
1205 GENEVE
PREJ ORES 19H30
PËR QDO KONTAKT
078/726.92.83
KONFERENCË ME Marin Memu
Mënyrë organizimi: Niveli i agimit, shfaqje tradicionale të Shqipërisë, "Aja e Mëdha", Fjalë të shprehjeve të Agimitit.
Kontakt: 078 882 88 88 / 078 882 88 88

Gjatë kësaj periudhe janë bërë shumë shpallje me kërkesë të shoqatave dhe institucioneve të ndryshme: Katedrës për arkeologji të Universitetit të Gjenezës, Klubit të futbollit FC Kosova për turnir futbollit, Filmotekës së Zvicrës për shfaqjen e filmit "Burrneshat", Shoqatës Zhegra për "Ditët e Shqipes", promovimi i librit të Bardhyl Mahmutit, për votim kundër iniciativës së partisë UDC dhe shumë të tjera.

2. Prodhimi i video-klipit kushtuar 1650 personave të zhdukur në Kosovë

Në bazë të tekstit dhe muzikës të përgatitur nga anëtarja jonë znj. Afërdita Krasniqi KShGj ka financuar prodhimin e video-klipit për këtë këngë. Ky klip për herë të parë u shfaq me rastin e përvjetorit të shoqatës "Jardin des disparus" nga Meyrini.



Klipi ka zgjuar kureshtje të madhe; është transmetuar nga disa televizione nacionale dhe lokale të Kosovës, kurse protagonistja e këtij klipi znj. Afërdita Krasniqi ka qenë



mysafire në disa emisione televizive. Në youtube ka pasur rreth 10'000 klikime.

3. Festa e Flamurit dhe 103 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë

Festa e Flamurit këtë vit është shënuar me një program të larmishëm dhe me pjesëmarrjen masive të publikut. Në program morën pjesë fëmijët e LAPSh-ës, grupet artistike nga Gjeneva: RiniaKontakt, Gëzuar, Rapsodët e Gjenevës, sikurse edhe artistët Afërdita dhe Shejtim Krasniqi, Ermira Zyrakja, Mimosza Nazarko, kurse e ftuar speciale ishte artistja e mirënjohur nga Kosova Miranda Hashani. E gjitha nën drejtimin artistik të znj. Mira Bregu. Në sallën Palladium të Gjenevës ishin prezent mbi 1000 spektator.



Në këtë mbrëmje, si zakonisht është bërë edhe prezantimi i studentëve shqiptar nga Gjeneva, të posa diplomuar në nivelin master nëpër Universitete zvicerane të cilëve iu nda nga një mirënjohje për përmasimin e imazhit tonë në Gjenevë dhe Zvicër.





Edhe më tutje mbetet problem gjetja e këtyre studentëve dhe ardhja e tyre në manifestim. Pra, në këtë pikë presim bashkëpunim më të gjerë.

Për organizimin dhe mirëvajtjen e festës ndihëm të çmuar kemi pasur edhe nga RiniaKontakti, kurse pjesëmarrje financiare, përveç KShGj dhe RiniaKontakti kemi pasur edhe nga LAPSh, USh, Gëzuar dhe Rapsodët. Në formë të donacionit apo në emër të sponsorizimit na kanë ndihmuar edhe firmat: Creanit, HyseniConstruction, Kosovafly, AXA Winterthur, Aligro, Intertours, Prishtina HB dhe sindikata Unia. I falënderojmë të gjithë.

4. Angazhimi kundër iniciativës së UDC-së për dëbimin e të huajve

Komuniteti Shqiptar i Gjenevës i është bashkangjitur shumë shoqatave, partive politike dhe sindikatave në fushatën kundër iniciativës së partisë UDC për dëbimin e të huajve për të cilën është organizuar referendum i me 28 shkurt 2016. Me këtë rast KShGj ka adaptuar një afishe në gjuhën shqipe të cilën e kemi shpërndarë anekënd

Zvicrës në mbi 600 adresa elektronike, me shpjegime të qarta pse kjo iniciativë duhet të refuzohet dhe pse është kundër interesave të shqiptarëve dhe të gjithë qytetarëve tjerë të Zvicrës që nuk kanë shtetësi zvicerane. Po ashtu edhe kundër interesave të vet Zvicrës dhe prestigjit të saj ndërkombëtar. Fale edhe kontributit tonë kjo iniciativë është refuzuar me 58% të votave.



Për ata që votojnë për herë të parë kemi realizuar një udhëzim video me shpjegime rreth mënyrës së votimit dhe e kemi vendosur në sajtin tonë dhe në youtube.


Kësaj radhe nuk pati vërejtje se "a po politizohet komuniteti shqiptar" që shpërfaq një selektivitet.

5. Gjendja financiare

Viti 2015 ka qenë i suksesshëm nga aspekti financiar sepse të ardhurat kanë qenë më të mëdha sesa shpenzimet për 2'650 fr. Merita për këtë i takon angazhimit të anëtarëve të kryesisë gjatë manifestimeve të ndryshme dhe donacioneve të donatorëve tanë.

Në Gjenevë, më 18 maj 2016

Kryetar
Ali Mehmeti





1. Misioni i informimit

Kërkesat që po na dërgohen për shpallje të ndryshme, nga shoqatat e ndryshme, tregojnë se Komuniteti Shqiptar i Gjenevës edhe më tutje mbetet një mjet i fuqishëm për informimin e bashkëkombësve tanë në Gjenevë rreth ngjarjeve të ndryshme, ato kulturore, sportive, në rastin e vdekjeve të bashkatdhetarëve tanë, madje edhe për ngjarje politike (zgjedhjet, referendumet). Kjo bëhet nëpërmjet postës elektronike meqenëse disponojmë me disa qindra adresa, sikurse edhe me sajtin tonë në internet. Na vazhdim, disa nga shpalljet dhe aktivitetet tona.



Gjatë kësaj periudhe, si zakonisht, janë bërë shumë shpallje me kërkesë të shoqatave dhe institucioneve të ndryshme, sikurse edhe autorëve të veprave të ndryshme. Risia është se gjatë periudhës së fundit po lajmërohen studentët që janë duke përgatitur temat për mbrojtjen e masterit apo doktoratës nga fusha e integritimit, kurse nga ne kërkojnë korrespondentët që do u përgjigjen anketave të tyre.

2. Shfaqja teatrale "Apologjia e vërtetë e Sokratit"

Edhe gjatë këtij mandati kemi përgatitur dhe organizuar shfaqjen teatrale (monodramë) ku në rolin kryesor u shfaq Aktori ynë i madh, Nderi i Kombit z. Mirush Kabashi. Monodrama është realizuar sipas veprës së njohur të shkrimtarit Kostas Vernalis, kurse është shfaqur në teatrin Madelaine në Gjenevë, më 8 tetor 2016. Përveç angazhimit tonë disamujor dhe pjesëmarrjes financiare, kjo u mundësua edhe nga donacioni që iu akordua shoqatës tonë nga Loterie Romand në shumë prej 3'000 fr. Shfaqja ishte mjaft e vizituar, me rreth 250 spektator. Hyrja ishte 10fr, kurse anëtarët e rregullt të KShGj-së kishin nga 2 bileta falas. Kostoja e gjithmbarshme e shfaqjes ishte 8'000fr. Kjo shfaqje zgjoi interesimin dhe u pasqyrua nga dhjetëra mjete të informimit masiv, gazeta dhe televizione.



3. Festa e Flamurit dhe 104 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë

Festa e Flamurit këtë vit është shënuar me një program të larmishëm dhe me pjesëmarrjen masive të publikut. Në program morën pjesë fëmijët e LAPSh-ës, grupet artistike nga Gjeneva: RiniaKontakt, Gëzuar, Rapsodët e Gjenevës, sikurse edhe artistët Afërdita dhe Shpejtim Krasniqi, kurse i ftuar special ishte artisti i njohur nga Mali Zi Malësor Prenkoqaj. Edhe pse për herë të parë hyrja ishte me pagesë prej 5fr, pjesëmarrja ishte masive. Për organizimin dhe mirëvajtjen e festës ndihëm të çmuar kemi pasur edhe nga RiniaKontakti dhe shoqata "Vitia" kurse pjesëmarrje financiare, përveç KShGj dhe RiniaKontakti kemi pasur edhe nga ansambli "Gëzuar". Në formë të sponsorëve na kanë ndihmuar edhe firmat: Aligro, Kosovafly, "Hyseni Construction" dhe Prishtina HB. I falënderojmë të gjithë.



Nga fitimi i gjithmbarshëm prej rreth 2'874fr, gjysma i janë dhuruar shoqatës "Vitia", duke iu bashkangjitur aksionit të tyre humanitar për ndërtimin e shtëpive të pastrehëve në komunën e Vitisë, kurse gjysma tjetër është rezervuar për organizimin e festës vitin e ardhshëm.




Si zakonisht, edhe këtë vit është bërë prezantimi i studentëve shqiptar nga Gjeneva, të

posa diplomuar në nivelin master nëpër Universitete zvicerane të cilëve iu nda nga një mirënjohje për përmasimin e imazhit tonë në Gjenevë dhe Zvicër. Edhe më tutje mbetet problem gjetja e këtyre studentëve dhe ardhja e tyre në manifestim. Pra, në këtë pikë presim bashkëpunim më të gjerë.

4. Promovime librash

Gjatë periudhës së kaluar janë bërë edhe disa promovime librash në bashkëpunim edhe me shoqata tjera. Në bashkëpunim me Shoqatën e Studentëve Shqiptar në UniMail është bërë promovimi i librave "Leksikoni i autorëve shqiptar në Zvicër" nga Besnik Camaj dhe Shefqet Dibrani dhe "Tresors Albanais" nga Rina Çela - Grasett; kurse në bashkëpunim me shoqatën Zhegra dhe "Rrethi shqiptar-mejrinas" është bërë promovimi i romanit "Misioni rus".



Me rastin e ndarjes nga jeta të shkrimtarit tonë të madh Ditëro Agolli është bërë edhe një homazh duke recituar disa nga poezitë e tij më të njohura.



Të gjitha këto aktivitete janë përcjell edhe me një program artistik përkatës. Në promovimin e fundit ishte i pranishëm edhe Ministri i Diasporës z. Valon Murati.

5. Përkrahja e shoqatave tjera

Kësaj radhe kemi përkrahur shoqatën "Vitia" në aksionin e tyre për ndërtimin e shtëpive të pastrehëve në komunën e Vitisë me një shumë prej gjithsej 1'637fr, prej të cilave 200fr ishin nga fondi ynë, kurse të tjerat janë grumbulluar nga të ardhurat e Festës së Flamurit.


6. Takimi me këshilltarët komunal

Në muajin shkurt është mbajtur një takim me këshilltarët komunal me origjinë shqiptare. Ata paraqitën eksperiencat e tyre dhe u përgjigjen në pyetjet e të pranishmëve dhe treguan planet e tyre, kurse disa shprehen edhe dëshirën të konkurrojnë edhe për deputet në parlamentin kantonial të




Gjenevës. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe Zëvendësministri i Kulturës së Republikës së Kosovës z. Rexhep Hoti me të cilin u zhvillua një bashkëbisedim.

Kryetar
Ali Mehmeti



1. Misioni i informimit

Gjatë kësaj periudhe, si zakonisht, janë bërë shumë shpallje me kërkesë të shoqatave dhe institucioneve të ndryshme, sikurse edhe autorëve të veprave të ndryshme. Edhe më tutje po lajmërohen studentët që janë duke përgatitur temat për mbrojtjen e masterit apo doktoratës nga fusha e integritimit, kurse nga ne kërkojnë korrespondentët që do u përgjigjen anketave të tyre.



Takim me ilustratorin dhe skenaristin Gani Jakupi



Promovim librash dhe debat rreth kulturës shqiptare të organizuar nga Shoqata e Studentëve Shqiptarë të Gjenevës, Galeria Perspectives, Art9 dhe Komuniteti Shqiptar i Gjenevës

26 prill, 9 qershor 2017 nga ora 19.00-22.00 – Sala M280 në UniMail, Blvd. Pate d'Arve 40, 1204 Gjenevë

CONFERENCE / DIBAT

Me të martën 2 maj 2017 - Lokaliteti M280 - Ora 19.00

LECTURE / DIBATET E SHQIPTARËVE NË KOSOVË
 JAKUPI: NGA DREZDA NË KOSOVË
 JAKUPI: NGA DREZDA NË KOSOVË
 JAKUPI: NGA DREZDA NË KOSOVË

FC - KOSOVA GE

UNION FÉDÉRATIF E SHQIPTARËVE SHQIPTARË TRADITIONAL
 NË DREZDA NË TËRIQË E DREZDËS



Shprehjet:
 Vendi D: 06
 Vendi E: 06
 Vendi F: 06

Data: 17 Qershor 2018

Më 5 nëntor 2017 në orën 10h30 dhe 18h00

NENTORI I DYTË

Hyrja FALAS

Cinéma Théâtre l'Onex - Parc.
 Rue des Bössons 7
 1213 Onex

Ditët e kulturës shqiptare në Zvicër

Prillina e Drezdës
 Qendra Kulturale e Drezdës Jugut

REPUBLIKË

105 Njohuri e Gjuhës dhe Shqipërisë

Hamon Musliqaj

Gjuhë, Gjuhë dhe Gjuhësi në Shqipëri

105 Njohuri e Gjuhës dhe Shqipërisë

105 Njohuri e Gjuhës dhe Shqipërisë

INDEPENDANCE DU KOSOVO

DU EN EST LA LANGUE APRES

DATE: LUNDË 19 PRILLI & ENDS

LEU: MË 8 E 11

UNI BARTANS RUE DE CAROLLES 5
 1204 GENEVE

Informimi i bashkëkombësve tanë në Gjenevë mbi ngjarjet e ndryshme kulturore, sportive, në rastin e vdekjeve të bashkatdhetarëve tanë, madje edhe për ngjarje politike (zgjedhjet, referendumet), mbetet edhe më tutje një nga objektivat e rëndësishëm për Komunitetin Shqiptar të Gjenevës. Kjo bëhet nëpërmjet postës elektronike meqenëse disponojmë me disa qindra adresa, sikurse edhe me sajtin tonë në internet. Na vazhdim, disa nga shpalljet mbi aktivitetet tona dhe të tjerëve:

2. Takimi me ilustruesin, kompozitorin dhe skenaristin Gani Jakupi



Ilustruesi, kompozitori dhe skenaristi i njohur ndërkombëtar Gani Jakupi kishte një ekspozitë në galerinë "Art Perspectives" në Gjenevë. Shfrytëzuan rastin që në bashkëpunim me Shoqatën e Studentëve Shqiptarë të Gjenevës të organizojmë një takim në Universitetin e Gjenevës (UniMail) me studentët dhe publikun më të gjerë. Ishte rast i mirë për t'u njohur me një artist poliedrik i cili shpallosi disa nga aktivitetet e tij të shumta. Me këtë rast u promovua edhe romani i parë grafik në gjuhën shqipe "Imazhi i fundit", i cili paraprakisht ishte botuar në gjuhën frënge, realizuar në tërësi nga Gani Jakupi.

3. Shfaqja e filmit vizatimor "Borëbardha dhe shtatë xhuxhët" dhe filmit artistik dhe historik "Nëntori i Dytë"

Në shfaqjen e parë morën pjesë disa dhjetëra fëmijë të moshave të ndryshme nga klasat që mbajnë mësimin plotësues të gjuhës shqipe, sikurse edhe fëmijët nga ansambli "Gëzuar". Bashkë me ta ishin edhe disa mësuese. Në shfaqjen e dytë ishin të pranishëm fëmijët bashkë me prindërit e tyre. Megjithatë, numri i tyre ishte më i vogël se që pritej.

4. Ditët e kulturës shqiptare në Zvicër



Në bashkëpunim me Ministrinë e Diasporës së Kosovës, respektivisht me Qendrën kulturore të Kosovës në Cirihi është organizuar ekspozita dhe shfaqja teatrale "Stacioni 17b" interpretuar nga Studio aktrimi - Cirihi. Ky organizim është bërë në kuadër të "Ditëve të Kulturës Shqiptare në diasporë" i cili u mbajt për tri ditë, në tri qytete zvicerane. Përgjigja e publikut ishte shumë pozitive që u pa

nga numri i të pranishmëve dhe nga emocionet e shprehura gjatë shfaqjes.

5. Festa e Flamurit dhe 105 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë

Si zakonisht, edhe këtë vit Festa e Flamurit është organizuar në bashkëpunim edhe me shoqata tjera që veprojnë në kantonin e Gjenezës: Rinia Kontakt, Gëzuar, Vitia, Shoqata e Studentëve. Në aspektin financiar kemi pasur përkrahje nga RiniaKontakt dhe një sponsorizim nga firma Aligro. Programi ishte i larmishëm dhe i ndjekur nga një numër i konsiderueshëm të spektatorëve.

Në program morën pjesë fëmijët e LAPSh-ës, grupet artistike nga Gjeneva: RiniaKontakt dhe Gëzuar, sikurse edhe artistët Afërdita dhe Shpejtim Krasniqi, kurse i ftuar special ishte artisti i njohur Nimon Mushkolaj.




Moderatorët e mbrëmjes ishin dy vajza studente: Pranvera Svarqa nga Ferizaji dhe Kristela Tepelena nga Tirana.



Si zakonisht, edhe këtë vit është bërë prezantimi i studentëve shqiptar nga Gjeneva, të posa diplomuar në nivelin master nëpër Universitete zvicerane të cilëve iu nda nga një mirënjohje për përmasimin e imazhit tonë në Gjenevë dhe Zvicër. Edhe më tutje mbetet problem gjetja e këtyre studentëve dhe ardhja e tyre në manifestim. Pra, në këtë pikë presim bashkëpunim më të gjerë.

6. Takimi me kandidatët me origjinë shqiptare për Parlamentin dhe Qeverinë e kantonit të Gjenevës



Edhe këtë vit zgjedhor është bërë një përpjekje për të ndihmuar kandidatët me origjinë shqiptare. Është përgatitur materiali në gjuhën shqipe me udhëzime sesi duhet të votohet, është publikuar në sajtin e KShGj-së dhe është dërguar me postë elektronike në qindra adresa të shqiptarëve në Gjenevë. Po ashtu është thirrur edhe një takim me bashkatdhetarët i cili nuk pati ndonjë pjesëmarrje të pritshme.

Sigurisht që ky angazhim ka pasur, sado pak, ndikim në zgjedhjen e znj. Xhevrrie

Osmani për deputete në Parlamentin e Gjenevës (Grand Conseille).

7. Përkrahje e shoqatave tjera

Komuniteti Shqiptar i Gjenevës në çdo moment është i gatshëm të ndihmoj shoqatat tjera në mënyra të ndryshme, atëherë kur ato kanë nevojë. Kësaj radhe kjo ndihmë i është ofruar Lidhjes së Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptar (LAPSh) dhe Shoqatës së Studentëve Shqiptar të Gjenevës (ShSSHgj).

LAPSh-in e ndihmuam në ringritjen e tij organizative dhe financiare duke i dhuruar 2'000 chf, kurse ShSSHgj e ndihmuam financiarisht me 500 chf për organizimin e konferencës "Aktivizmi feminist në Kosovë".

Gjenevë, 4 maj 2018

Sekretar
Ali Mehmeti

Kryetare
Afërdita Krasniqi



RAPORTI I PUNËS 05 maj 2018 - 31 dhjetor 2019

1. Misioni i informimit

Informimi i bashkëkombësve tanë në Gjenevë mbi ngjarjet e ndryshme kulturore, sportive, në rastin e vdekjeve të bashkatdhetarëve tanë, madje edhe për ngjarje politike (zgjedhjet, referendumet), mbetet edhe më tutje një nga objektivat e rëndësishëm për Komunitetin Shqiptar të Gjenevës. Kjo bëhet nëpërmjet postës elektronike meqenëse disponojmë me disa qindra adresa, sikurse edhe me sajtin tonë në internet. Na vazhdim, disa nga shpalljet mbi aktivitetet tona dhe të tjerëve gjatë kësaj periudhe:



Gjatë kësaj periudhe, si zakonisht, janë bërë shumë shpallje me kërkesë të shoqatave dhe institucioneve të ndryshme, sikurse edhe autorëve të veprave të ndryshme. Edhe më tutje po lajmërohen studentët që janë duke përgatitur temat për mbrojtjen e masterit apo doktoratës nga fusha e integritimit, kurse nga ne kërkojnë korrespondentët që do u përgjigjen anketave të tyre.

2. Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit Skënderbeu

Me rastin e 550 vjetorit të vdekjes së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu,



viti 2018 është shpallur Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit Skënderbeu. Për ta shënuar

këtë përvjetor kemi organizuar një konferencë në lokalet e Universiteti të Gjenevës në bashkëpunim edhe me shoqatën e Studentëve Shqiptar të Gjenevës me titull "Portreti i vërtet i Skënderbeut sipas dokumenteve". Për ta mbajtur një ligjëratë të tillë vështirë ishte të gjendet një person më i mirë sesa prof. Pëllumb Xhufi.

Ky rast u shfrytëzua edhe për ndarje të një mirënjohjeje për bashkëkombësin dhe bashkëqytetarin ton, prof. Astrit Leka, për kontributin e tij të pazëvendësueshëm në vendosjen e bustit të Heroit tonë Kombëtar në Gjenevë. Kjo konferencë pati një numër të madh të pjesëmarrësve, sidomos nga radhët e studentëve të Gjenevës.

3. Shfaqja e filmit artistik "Babushi"



Një film si dramë familjare që gjenezën e ka në humbje të idealeve të luftës dhe keqpërdorimet kriminale të pas luftës. Në shfaqjen morën pjesë disa dhjetëra të bashkatdhetarëve tanë. Mes nesh ishin edhe dy nga aktorët Met Haxhosaj dhe Ilmi Hajzeraj.

4. Shfaqja e filmit dokumentar "Një jetë... në tre epoka"

Radio Televizioni Shqiptar ka përgatitur filmin dokumentar "Një jetë... në tre epoka", kushtuar një personaliteti të rrallë, siç është prof. Astrit Leka, në regji dhe me skenar të Engjëll Ndocajt.



Në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut ne promovuam këtë film në Universitetin e Gjenevës në prani të shumë personaliteteve, ku spikati edhe mysafiri ynë, kryetari i Skënderajt Bekim Jashari, pinjoll i familjes së lavdishme Jashari.

5. Festa e Flamurit dhe 106 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë

Festa e Flamurit këtë vit 2018 është shënuar me një program të larmishëm dhe me pjesëmarrjen masive të publikut. Në program morën pjesë fëmijët e LAPSh-ës, grupet artistike nga Gjeneva: Riniakontakt, Gëzuar, sikurse edhe artistët Afërdita dhe Shpejtim Krasniqi dhe për herë të parë para publikut u paraqit edhe Kori "Nostalgjia" që veprimtarinë e vet e filloi në kuadër të Komunitetit Shqiptar të Gjenevës. Përveç kësaj i kishim edhe disa mysafirë. Mysafirin e nderit pinjollin e familjes së lavdishme Jashari, që njëkohësisht është edhe kryetar i komunës së Skënderajt Bashkim Jasharin dhe mysafirë tjerë të ftuar, ambasadorin e Republikës së Shqipërisë Ilir Gjoni, Konsullin gjeneral të Kosovës në Zvicër Ramadan Avdiu dhe kryetarin e komunës së Vitisë Sokol Haliti.



Për disponimin e mirë është kujdesur këngëtari ynë i mirënjohur Malësor Prënkoçaj. Si zakonisht, edhe këtë vit është bërë prezantimi i studentëve shqiptar nga Gjeneva, të posa diplomuar në nivelin master nëpër Universitete zvicerane të cilëve iu nda nga një mirënjohje për përmasimin e imazhit tonë në Gjenevë dhe Zvicër. Edhe më tutje mbetet problem gjetja e këtyre studentëve dhe ardhja e tyre në manifestim. Pra, në këtë pikë presim bashkëpunim më të gjerë.

Moderatorët e mbrëmjes ishin Ardita Kamberi dhe Labinot Ramadani.

6. Karriget e invalidëve

Anëtarja e komunitetit tonë Mergime Bajrami na është paraqitur me një informacion se ka 4 karrige të invalidëve të përdorura, të cilat do të doje ti dërgoj në Kosovë dikujt që ka nevojë. Me datë 26 qershor 2019 karriget i janë dorëzuar firmës "Eliot Trans" (av. Saint-Dyck 7-9, 1267 Coinsins) me pronar Vesel Ilazi, me lutje që ti dorëzon në Prishtinë, organizatës që merret me problemet e invalidëve "Hendikos". Ky e pranoi këtë detyrë pa kërkuar ndonjë kompensim monetar. Pas pak ditësh karriget ishin dorëzuar në destinacionin e kërkuar, për çka jemi mirënjohës.

7. Pjesëmarrje në turnir të futbollit

Klubi i futbollit "FC Kosova" nga Gjeneva tradicionalisht organizon turnirë në futboll të vogël. Kësaj radhe edhe shoqata jonë morri pjesë me një ekip, me përkrahje financiare dhe me mobilizimin e publikut.



8. Shfaqja e monodramës "Nostalgjia"

Në bashkëpunim me ansamblin "Gëzuar" kemi shfaqur monodramën "Nostalgjia" me autor dhe interpretues z. Mario Caliva. Një autor arbëresh i cili na emocionoi në një gjuhë arkaike shqipe. Shfaqja u përcoll edhe me këngë arbëreshe të interpretuar nga kori "Nostalgjia".



Me 2 nëntor 2019 u shfaq edhe filmi "Kodi i nderit", film i metrazhit të gjatë me skenar nga Valton Jakupi dhe Lirie Sahiti. Filmi flet për fëmijët jetim binjak, për jetën dhe vështirësitë e tyre në familje të papërgjegjshme.

9. Përkrahja shoqatave tjera

Komuniteti Shqiptar i Gjenevës në çdo moment është i gatshëm të ndihmoj shoqatat tjera në mënyra të ndryshme, atëherë kur ato kanë nevojë dhe sipas mundësive. Kësaj radhe kjo ndihmë i është ofruar:

AlbSuisse - një televizioni në krijim me 300 fr (02.07.2018)

Klubit të futbollit "FC Kosova" me 500 fr (09.11.2018)

Lidhja e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë - 2'000 fr me 09.01.2019

Ansambli "Gëzuar" për udhëtim në Zhegër me rastin e festimit të "Ditëve të Agim Ramadanit" me 500 fr (17.05.2019)

Duhet përmendur se në këtë periudhë, me 30 dhjetor 2019, kemi pranuar edhe një donacion financiar në lartësi prej 1'000 fr, nga firma private "Kouleta" nga Gjeneva, me pronar Përparim Arifi dhe Fortesa Mehmeti, për çka jemi mirënjohës.

Gjenevë, 31 dhjetor 2019

Sekretar
Ali Mehmeti



Kryetare
Afërdita Krasniqi





RAPORTI I PUNËS janar 2020 – 31 dhjetor 2021

1. Misioni i informimit

Informimi i bashkëkombësve tanë në Gjenevë mbi ngjarjet e ndryshme kulturore, sportive, në rastin e vdekjeve të bashkatdhetarëve tanë, mbetet edhe më tutje një nga objektivat e rëndësishëm për Komunitetin Shqiptar të Gjenevës. Kjo bëhet nëpërmjet postës elektronike meqenëse disponojmë me disa qindra adresa, sikurse edhe me sajtin tonë në internet. Na vazhdim, disa nga shpalljet mbi aktivitetet tona dhe të tjerëve:



Tri këndomë Flamurit!
E shtunë, 11 Janar 2020
Hapja e dyerave ora 19:30
Fillimi ora 19:00

Marin pjesë:
Flamja e LAPSh-t
Ansamblë "Gëzuar"
RënkContact
Aktorja dhe Shpëtim Krasniqi
Fëlim Lallë - shërbëtor
Fadi Kozica - Vëllor
Moderatore
Aulona Lila

Mysafir special: HEKURAN KRASNIQI

Konsumi 10 fr.
Për fillim të hëdras në vit 2004 - PALAS
Tram 14 edhe 48
Stacioni Baloxart



KINO KOSOVA

Kino Kosova - adreca i dytë këtu vit në Bern në Kuvendit dhe për herë të parë në Cyrih në kinematë RIFFRAFF dhe në Gjenevë në kinematë CIVILIC, krijoi hapësirë për film aktual nga Kosova dhe diaspora. Filmat e zgjedhur të shkurtrë, dokumentarë dhe artistikë trajtojnë perspektiva të ndryshme në vendet e jashtme të dhe pasqyrojnë mendimet e veçanta mbi Zvicrën dhe Kosovën.

Përveç filmave, audienca do të ketë mundësi për të bërë takime me artistët dhe diskutime në panel dhe koncerte.

Kino Kosova tregon historinë dhe mënyrën e ndryshme dhe kështu tregon një vend shprehës mbi komunitetin në ndryshim.

Në rastin që në zbulimin e potencialit transformues të artit dhe filmave. Forma të mëdha të shkurtrë, dokumentarë dhe artistikë tregojnë mbi çështje komplekse në një mënyrë të re, reflektuese dhe të thjeshtë. Dhe pa marrë parasysh rrethet tërësisht politike, kështu, eksperimentale apo e përzierituar në një përvojë të re të bërë të preferencës, mënyrë dhe tërësisht.

Temat e filmave unike, historitë politizuar dhe të trashëguara, na bëjnë të mendojmë, funksionet dhe mund të na japin një përvojë të re. Kino Kosova diskuton të bashkëkohshmeve të artit dhe të ndryshmeve të artit dhe të kulturës në një mënyrë të re, reflektuese dhe të thjeshtë. Dhe pa marrë parasysh rrethet tërësisht politike, kështu, eksperimentale apo e përzierituar në një përvojë të re të bërë të preferencës, mënyrë dhe tërësisht.

Kino Kosova është organizuar nga KULTURALINK - organizatë e kulturës në Bern që punon kryesisht me art dhe kulturë.

Nga koncertet në teatro të shkurtrë e vëllimë deri në laborator publik. Kulturën që rritet në bashkë.

Misioni na kryejnë artistë të reja dhe programi i shprehës për artistët dhe të reja në përgjithësi, të cilët performojnë artistikë, të cilët si fotograf, video, teatro, art figurativ dhe muzikë, si një mënyrë për promovim dhe kuzhinë e kulturës sociale dhe përmirësimi të ndryshme të.

Informata të mëtejshme të programit gjenden në faqen tonë të internetit

www.kinokosova.com



FIF&G
THE FLYING CIRCUS
DE FETES BERNE
SAMEDÌ 26 JUN A 15:30
AUX CINEMAS DU GRÜTLI
EN PRESENCE DU REALISATEUR ET DE LA PRODUCTRICE
EN PARTENARIAT AVEC L'ASSOCIATION COMMUNAUTE ALBANAISE DE GENEVE

SHOQATA E STUDENTËVE SHQIPTAR TË GJENEVËS dhe KOMUNITETI SHQIPTAR I GJENEVËS
"Në kërkim të Idesë" - një tregim dramatik dokumentar nga autori AB Sh. Mehmet

Më 19 nëntor 2021, ora 19:00
Hapja e dyerave 18:30
Universiteti i Gjenevës
UnivMail - sala M 2193
24, rue du Général-Dufour
1211 Genève



Masat e obligueshme anti pandemie:
- Certifikata e vaksinimit me dy dozë, ose
- testi negativ PCR, më i ri se 72 orë ose
- testi negativ antigjenik, më i ri se 48 orë
KONTROLI BEHET NË HYRJE

Mysafir special:
prof. Agim Vinca
Shkrimtar dhe Redaktor i librit



Grupi "Hareja"
Emrila Lefot
Voltri Haxhijaj

FESTA E FLAMURIT
Ndarja e mirënjohjeve për studentët e diplomuar në Gjenevë
Certifikata Covid-19 obligueshme
UnivMail 28 Nëntor 2021
Bd. Du Pont d'Arve 40 ora 13:30
Geneve



Komuniteti Shqiptar Gjenevë
Communauté Albanaise Genève
www.cageneve.ch

Gjatë kësaj periudhe, si zakonisht, janë bërë shumë shpallje me kërkesë të shoqatave dhe institucioneve të ndryshme, sikurse edhe autorëve të veprave të ndryshme.

2. Festa e Flamurit dhe 107 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë

Festa e Flamurit këtë vit nuk shkoi siç ishte paraparë. Pak ditë para kremtimit të paraparë më 28 nëntor 2019 ndodhi tërmeti shkatërrues në Shqipëri që mori shumë jetë njerëzish, plagosi dhe la pa kulm mbi kokë me mijëra familje. Në shenjë solidariteti kremtimi ynë u shty për 11 janar 2020.

Në program morën pjesë fëmijët e LAPSh-ës, grupet artistike nga Gjeneva: RiniaKontakt, Gëzuar, sikurse edhe artisti nga Kosova Hekuran Krasniqi me artistët nga Gjeneva: Bardh, Ramadani, Afërdita dhe Shpejtim Krasniqi dhe grupi "Hareja". Moderimin e mbrëmjes e bëri Aulona Lila.



Si zakonisht, edhe këtë vit është bërë prezantimi i studentëve shqiptar nga Gjeneva, të posa diplomuar në nivelin master nëpër Universitete zvicerane të cilëve iu nda nga një mirënjohje për përmasimin e imazhit tonë në Gjenevë dhe Zvicër. Edhe më tutje mbetet problem gjetja e këtyre studentëve dhe ardhja e tyre në manifestim. Pra, në këtë pikë presim bashkëpunim më të gjërë.

PAS KËTIJ KREMTIMI PASOI NJË PAUZË E GJATË NË AKTIVITETET TONA, SEPSE GLOBIN E KAPLOI VIRUSI COVID-19 DHE U SHPALL PANDEMIA GLOBALE. KREMTIMIN E FESTËS SË PAVARËSISË NË VITIN 2020 NUK E ORGANIZUAM FARE, POR URIMIN E BËRI KRYETARJA JONË AFËRDITA KRASNIIQI ME NJË VIDEO PARAQITJE.

NË NDËRKOHË, MEGJITHATË, PATI DISA AKTIVITETE NË MOMENTE KUR VALA E PANDEMISË KISHTE NJË ULJE TË INTENSITETIT. AKTIVITETI I PARË ISHTE NË QERSHOR TË VITIT 2021:

3. Shfaqja e filmit artistik "Cirku Fluturues"

Përkundër shumë kufizimeve, sikur masa mbrojtëse ndaj virusit covid-19, sa i përket numrit të pranishmëve brenda ambienteve të mbyllura, në Gjenevë u organizua Festivali i Filmit Oriental (FFOG). Në këtë festival e shfaq edhe filmi nga Kosova "Cirku Fluturues", me pjesëmarrje financiare të shoqatës sonë, filmi që përshkruan përpjekjet e artistëve të Kosovës për të mos braktisur artin dramaturgjik, përkundër terrorit të pushteti okupues serb në Kosovë, gjatë viteve 1990-99. Filmi e fitoi çmimin e dytë të jurisë profesionale. Mysafir e kishim regjisorin dhe producentin e filmit Fatos dhe Vjosa Berisha.



4. Promovimi i librit "Në kërkim të Idesë"

Momenti i dytë kur virusi covid-19 humbi paksa fuqinë u shfrytëzua për promovimin e librit të autorit Ali Sh. Mehmeti që njëkohësisht është edhe sekretar i KShGj-së.



Bëhet fjalë për një tregim dramatik dokumentar, siç e kualifikoi redaktori i librit prof. Agim Vinca që ishte i pranishëm në këtë promovim dhe mbajti fjalën hyrëse. Ish ambasadori i Shqipërisë në Zvicër Vladimir Thanati mbajti po ashtu një fjalë rasti, kurse Edon Duraku dhe Rrezarta Bislimi nga Shoqata e Studentëve Shqiptarë në Gjenevë shfrytëzuan rastin ta paraqesin para publikut aksionin e tyre "1637" që ka të bëjë me personat e zhdukur nga lufta e fundit në Kosovë.

Grupi "Hareja" i dha karakter festiv këtij promovimi.

5. Festa e Flamurit dhe 109 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë

Përvjetori i 109 na gjeti me masa kufizuese në lidhje me pandeminë që nuk lejonte organizime masive, siç i bënim rëndom. Prandaj e ndryshuam konceptin dhe në bashkëpunim me Shoqatën e Studentëve Shqiptarë të Gjenevës organizuam një kremtim më modest në njërën nga sallat e Universitetit të Gjenevës. Një fjalë rasti mbajti Ali Mehmeti, sekretar i KShGj-së. Këtë tubim e përshëndeti edhe miku ynë prof. François Lefort, ish Kryetar i Parlamentit të kantonit të Gjenevës nga Partia e gjelbër.



Studentëve shqiptarë nga Gjeneva, që kishin përfunduar studimet nëpër universitetet e



Zvicrës iu ndanë mirënjohjet për kontributin e tyre në përmirësimin e imazhit të komunitetit tonë. Po ashtu iu dhurua edhe nga një libër "Në kërkim të Idesë" nga autori Ali Sh. Mehmeti.



6. Përkrahja e shoqatave tjera

Komuniteti Shqiptar i Gjenevës në çdo moment është i gatshëm të ndihmoj shoqatat tjera në mënyra të ndryshme, atëherë kur ato kanë nevojë dhe sipas mundësive. Kësaj radhe kjo ndihmë i është ofruar Shoqatës së Studentëve Shqiptarë të Gjenevës së cilës iu dhanë 400 fr. për ta realizuar projektin e tyre në realizimin e një filmi dokumentar kushtuar grave të Krushës së Madhe, respektivisht heroinës së tyre Fahrije Hoti.

Gjenevë, 31 dhjetor 2021


Sekretar
Ali Mehmeti

Kryetare
Afërdita Krasniqi

1. Misioni i informimit

Periodua pandemike sikur ka lënë gjurmë të thella në aktivitete të shumë shoqatave të cilat ende nuk e kanë rimarrë mirë vetën. Prandaj edhe kanë munguar aktivitete më të ngjeshura.

Megjithatë, informimi i bashkëkombësve tanë në Gjenevë mbi ngjarjet e ndryshme kulturore, sportive dhe të tjera mbetet edhe më tutje një nga objektivat e rëndësishëm për Komunitetin Shqiptar të Gjenevës. Kjo bëhet nëpërmjet postës elektronike meqenëse disponojmë me disa qindra adresa, sikurse edhe me sajtin tonë në internet.



2. Pjesëmarrja në Aulona-Inter-Folk Festival në Vlorë

Festivali tradicional që mbledh grupet folklorike nga shumë vende të botës kësaj radhe ka mirëpritur edhe grupin "Hareja" që vepron në kuadër të Komuniteti Shqiptar të Gjenevës. KShGj edhe e ka ndihmuar financiarisht me 1'000CHF, kurse ansambli "Gëzuar" e ka ndihmuar me 300CHF. Për një paraqitje të shkëlqyer u nderuan edhe me mirënjohje nga organizatori i festivalit.



3. Shfaqja e filmit artistik "Bolero në vilën e pleqve"

Në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit Oriental që mbahet tradicionalisht në Gjenevë, kemi kontribuar në mënyrë aktive dhe financiare në përzgjedhjen e filmit "Bolero në vilën e pleqve" me aktorët e njohur Robert Ndrenika dhe Margarita Xhepa, sikurse edhe me aktoren e re nga Shkupi Gentiana Ramadani e cila ishte edhe mysafire e jonë gjatë qëndrimit në festival. Filmi u shfaq në kinemanë "Grutli" me një numër të kënaqshëm të shikuesve. Pas shfaqjes së filmit KShGj ofroi edhe një aperitiv.

4. Festa e Flamurit dhe 110 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë

Festa e Flamurit këtë vit është shënuar me një program të larmishëm, i mbështetur ekskluzivisht në forcat tona lokale artistike dhe me pjesëmarrjen masive të publikut. Në

program morën pjesë fëmijët e LAPSh-ës, grupet artistike nga Gjeneva: RiniaKontakt, Grupi Hareja dhe Gëzuar, sikurse edhe artistët Afërdita dhe Shpejtim Krasniqi, Drita Sahiti, Bardh Ramadani, Elion Krasniqi dhe Evin Thana me Véronique Aeschimann.



Në organizim ka pasur edhe vullnetarë që na kanë ndihmuar në mbajtjen e rendit dhe shitjes së pijeve në bar (Vllaznim Bityqi dhe Gafurr Dashi me punëtorët e vet). Si zakonisht, edhe këtë vit "Aligro" na ka ndihmuar me 300fr.

Po ashtu, edhe këtë vit është bërë prezantimi i studentëve shqiptar nga Gjeneva, të posa diplomuar në nivelin master nëpër Universitete zvicerane të cilëve iu nda nga një mirënjohje për përmasimin e imazhit tonë në Gjenevë dhe Zvicër. Edhe më tutje mbetet problem gjetja e këtyre studentëve dhe ardhja e tyre në manifestim. Pra, në këtë pikë presim bashkëpunim më të gjerë.

5. Koncert me Grupin polifonik nga Vlora

Kërkesa e dërguar Loterie Romand për ndihmë financiare për realizimin e ardhjes në Gjenevë të grupit polifonik "Bilbili" nga Vlora, ka hasur në mirëkuptim, duke marrë në konsideratë vlerën e polifonisë shqiptare që është e aprovuar sikur pasuri kulturore jomateriale botërore, e shpallur nga UNESCO. Ndihma e tyre prej 7 mijë franga ishte afër gjysmës së shumës së nevojshme. Pjesa tjetër është siguruar nga shitja e biletave dhe nga fondi i KShGj-së. Përveç kësaj ndihmë të rëndësishme na kanë ofrua edhe shoqatat "Iliria"

nga Saint-Julien-en-Genevois, RiniaKontakt dhe ansambli "Gëzuar" që ju kanë ofruar disa herë darka dhe dreka mysafirëve tanë që nuk ishin të pakët në numër.



6. Pjesëmarrja në Festën e Valleve në Çifte (Civita) të Kalabrisë - Itali

Me ftesë të organizatorit, që është komuna Çifte në Kalabri, grupi "Hareja" ka marrë pjesë në festën tradicionale disa shekullore që mbahet në këtë fshat arbëresh; me pjesëmarrje në një koncert dhe me defile me veshje kombëtare të shumë grupeve folklorike nga shumë fshatra të Kalabrisë; me vizita në disa fshatra të tjerë të Kalabrisë dhe me vizitë në Bibliotekën e At Antonio Belushit është realizua një vizitë kuptimplote.



At Antonio Belushi është një prift ortodoks që ruan dhe kultivon gjuhën arbëreshe (gjuhën arkaike shqipe), nga koha e Gjergj Kastriotit Skënderbeut.



Kryetarja e KShGj dhe njëkohësisht edhe udhëheqëse e grupit "Hareja" u nderua edhe me një mirënjohje nga kryetari i komunës Civita z. Alessandro Tocci, për pjesëmarrje në këtë festë të madhe.

Gjenevë, 20 prill 2023

Sekretar
Ali Mehmeti

Kryetare
Afërdita Krasniqi



Pellumb Xhufi

À moi

De: Pellumb Xhufi <p...@gmail.com>
à: KomShqip-ComAlb - Geneve <cageneve@gmail.com>
Date: 14 sept. 2023 14:19

I dashur z. Mehmeti,

Ju falënderoj për mesazhin dhe ju uroj përzemërsisht për aktivitetin jubilar me rastin e 10-vjetorit të krijimit të Shoqatës "Komuniteti Shqiptar i Gjenevës". Po mendojmë edhe unë të them diçka nga mbresat nga aktivitetet e Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut të 4 majit 2018. Kërkoj ndjesë paraprakisht, se kanë kaluar 5 vjet dhe jo gjithçka më ka mbetur në kujtesë. Shëndet e punë të mbarë,

Kur i ftuar nga Shoqata "Komuniteti Shqiptar i Gjenevës", në 4 maj 2018 mora pjesë në veprimtarinë për "Vitin Mbarëkombëtar të Skënderbeut", më tërhoqën vëmendjen dy fakte të veçanta. E para, konstatova se kjo Shoqatë e ka fokusuar objektivin e saj në çështje, ngjarje dhe personalitete, që sot e gjithë ditën i bashkojnë shqiptarët e të gjitha trevave, e të gjitha bindjeve, e të gjitha besimeve. Nga takimet me drejtues e anëtarë të Shoqatës formova bindjen se një orientim i tillë i drejtë dhe atdhetar i veprimtarisë së saj buronte nga dija, kultura e lartë dhe vizioni i drejtuesve dhe i anëtarëve të asaj shoqate. Shumë vepra, pak fjalë, hiç mburrje. Këto janë virtyte të grave e burrave të mençur, që pata kënaqësinë t'i njoh gjatë qëndrimit tim në Gjenevë.

Mjerisht nuk i kanë këto virtyte të gjitha shoqatat e shqiptarëve nëpër botë. Si studjues e si diplomat më ka qëlluar të kem të bëj me mjaft nga këto shoqata. Ka mes tyre të tilla, që janë krijuar mbi baza krahinore, politike, fetare. Të tilla shoqata kanë qysh në fillësë farën e ndarjes, jo të bashkimit. Shoqata juaj është antipodi i tyre. Ju keni ditur të dalloni mes faktorëve divergjentë dhe atyre konvergjentë. Dhe jeni fokusuar tek këta të fundit. Një vit pas takimit të paharruar në Gjenevë, në kuadrin e 100-vjetorit të Konferencës së Paqes së Versajës (1919), u mora me një studim mbi rolin e shoqatave patriotike, brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtje të interesave kombëtare në atë forum, që rrezikonte të sanksiononte një copëtim të ri të trojeve shqiptare, pas atij të Konferencës së Londrës të vitit 1913. Nga ai studim më rezultonte se, akoma më shumë se delegacioni shtetëror shqiptar, përgjegjësinë dhe vizionin atdhetar në nivelin më të lartë në atë ngjarje e përfaqësonin Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" dhe gjithashtu "Komiteti Shqiptar i Gjenevës". Me promemoret e rezolutat që i dërguan Presidentit Wilson, kancelerive evropiane dhe delegacionit të qeverisë shqiptare në Konferencën e Paqes, këto dy organizata patriotike luajtën një rol themelor në shmangien e një copëtimi të ri të trojeve shqiptare. Nuk e fshih, se kur shkruaja kumtesën për atë ngjarje, sa herë që më dilte emri i Komitetit Shqiptar të Gjenevës i vitit 1919, ky emër më asociohej spontanisht me "Komunitetin Shqiptar të Gjenevës" të vitit 2019. Nuk është thjesht vendi që i bashkon këto dy organizata shqiptare jashtë atdheut. Janë interesat e larta të Kombit, që ju, ashtu si paraardhësit tuaj keni vënë në fokusin e angazhimeve dhe veprimtarive, të cilat ju i kryeni në mënyrë vullnetare, por me një pasion e idealizëm të pashoq. Prandaj, në këtë vit jubilar për Shoqatën tuaj të merituar, unë kam nderin dhe kënaqësinë i uroj asaj të rrojë e të lulëzojë në shekuj, dhe ju të gjithëve, drejtuesve dhe antarëve të saj punë të mbara e të dobishme, shëndet e gëzime në familjet tuaja.

nderim e respekt të veçantë,
Akad. Pëllumb Xhufi



Daut Demaku

À moi

De: **Daut Demaku** <daut
à: KomShqip-ComAlb - Geneve <cageneve@gmail.com>
Date: 7 sept. 2023 15:56
Objet: Re: Komuniteti Shqiptar Gjenevë
Envoyé par: gmail.com
signé par: gmail.com
sécurité:  Chiffrement standard (TLS) [En savoir plus](#)
👉 : Ce message est important, en particulier parce que vous lisez souvent les messages associés à ce libellé.

Organizimi i juaj nuk është HARMONI E ÇITELIVE, POR ËSHTË HARMONI E VIOLINAVE NË SIMFONINË E MADHE KOMBËTARE., UROJ TË VAZHDONI KËSHTU, SEPSE VETËM GUXIMTARËT E BUTË JANË FITIMTARË TË VËRTETË.


Me shumë respekt, falënderim dhe urim ta RUANI VULLNETIN DHE DASHURINË PËR ATDHEUN,

D.D.



Gani JAKUPI

À moi

De: **Gani JAKUPI** <gani
à: KomShqip-ComAlb - Geneve <cageneve@gmail.com>
Date: 15 sept. 2023 22:19
Objet: Re: Komuniteti Shqiptar Gjenevë
Envoyé par: yahoo.es
signé par: yahoo.es
sécurité:  Chiffrement standard (TLS) [En savoir plus](#)
👉 : Ce message est important, en particulier parce que vous lisez souvent les messages associés à ce libellé.

N'at qershorin tashmâ t'largët të vitit 2017, galeristi im ma organizoi një ekspozitë në Zhënevë dhe njilherit kërkoi kontakte me komunitetin shqiptar lokal. Mbas hapjes së ekspozitës në pjesën e vjetër të qytetit, dhe një interviste mbresëlënëse me gazetaren Vjosa Gërvalla, u gjinda në amfiteatrin e Univerzitetit, si musafir i Shoqatës së Komunitetit Shqiptar.

Kam pasë shumë prezentime dhe aktivitete t'ndryshme nga atëherë, por ende e kam t'freskët kujtimin e mikëpritjes seriozisht të pregaditun. Natyrisht se nuk i mbajë mâ mend t'gjitha pyetjet që m'u banë, as atô që u thanë për mue, por nuk e harroj kurr ngrohtësinë e atyne momenteve. Janë situata kur njeriu e ndien vehtën edhe jashtë vendit, edhe mbrenda kombit të vet.

Gani Jakupi, vizatues dhe skenarist i romaneve grafike, gazetar dhe xhaz kompozitor



sejmen gjokoli

À moi

De: sejmen gjokoli <sgjokoli5...

à: KomShqip-ComAlb - Geneve <cageneve@gmail.com>

Date: 12 sept. 2023 15:12

DIMENSIONI KULTOROR I NJË SHOQATE

Shënime nga turneu kulturor i Folk Grup "Bilbili" në Gjenevë, mars-2023

Kur Grupi "Hareja" mbriti në Vlorë për të marrë pjesë në edicionin e katërbëdhjetë të Festivalit Ndërkombëtar "Aulona Folk", askush nuk e mendonte se pikërisht ky do të ishte edhe rasti i lidhjes për tu realizuar bashkëpunimi kulturor mes Shoqatqës "Komuniteti Shqiptarëve të Gjenevës" dhe Folk Grupi "Bilbili" të Vlorës.

U desh vetëm pak rakordim dhe Ali mehmeti, sekretari i shoqatës në mënyrën më fantastike, me një përsosmëri e skrupulozitet të hatashëm arriti ti kryej në një kohë record të gjitha çështjet procedurale e burokratike. Përmes një komunikimi të pa ndërprerë, në lidhje të përherëshme edhe me kryetaren, Afërdita Krasniqi, u arrit të harthohet më së pari një axhendë e cila për anëtarët e grupit nga Vlora të ishte sa më atraktive e mbresëlënëse.

Dhe kështu ndodhi. Në mbrëmjen e datës 27 mars 2023 anëtarët e grupit, të gjashtëmbëdhjetë, zbritën në Aeroportin e Gjenevës.

Atë mbrëmje një pritje e pa harruar, një ceremonial pritje që veç anëtarët e "Komunitetit Shqiptar të Gjenevës" mund ta organizojnë të tillë. Të gjithë të bërë bashkë aty në shtëpinë-vilë të Shaip e Luljeta Dedës, këta të fundit të shoqatës "Iliria" në Francë. Emocione të pa përshkuara, momente me të vërtetë të jashtëzakonshme në atë pritje aq shumë vëllazërore, organizuar aq hishëm e aq shumë hareshëm.

"Bilbilat" nga Vlora në mesin e bilbilave të "Haresë" e anëtarëve të tjerë të shoqatës në një kombinacion të pa parë këngësh e melodish nga më të bukurat, të gjitha këngë të hareshme shqiptarie ku polifonia e jugut u ndërthur aq bukur me melosin e këngëve kosovare. Gjatë ditëve të qëndrimit në Zvicër grupi zhvilloi dy koncerte zytare, njëri në Teatrin Madeleine në Gjenevë dhe tjetrin në Kështjellën Avully të Francës, të dy me shumë emocione.

Ndërkohë ashtu si në darkën e pritjes mbresëlënëse mbetet mikpritja e organizuar në mbrëmjen e fundit përpara largimit në qendrën e Ansambllit "Gëzuar" udhëhequr nga njeriu artist Fadil Avdija. Koncerti i përbashkët që u zhvillua në këtë qendër ku krahas valltarëve të grupit "Gëzuar" performuan edhe Folk Grup "Bilbili" e Gr upi "Hareja" mbetet vërtet mbresëlënëse. Darka e organizuar, gatimet edhe këtu tradicionale e bënë darkën nga më të bukurat po edhe më të hareshmet.

Dua ti mbyll këto shënime me publikimin e tekstit të këngës "Në Gjenevë të Helvetisë, Bilbilat e Labërisë", shkruar e realizuar posaçërisht për vëllezërit tanë të cilët na pritën me shumë dashuri e përkujdesje dhe që gjatë turneut në tokën helveticane u kthye në lajtmotiv.

NË GJENEVË TË HELVETISË, BILBILAT E LABËRISË

Teksti : Sejmen Gjokoli

Kënduar nga grupi "Bilbili", Vlorë

Në Gjenevë kemi ardhë,
Nga Vlora me det e valë.
Bilbilat e Labërisë,
Në Gjenevë të Helvetisë.





Mbledhur bashkë nga çdo anë,
Shkup, Prishtinë dhe Tiranë.
Në tokën e Helvetisë,
Nga çdo trevë e shqiptarisë.

Derdhur në këng e në valle,
Gjithë tradita kombëtare.
Vëllezër të gjithë gëzuar,
Nga zoti qofshi bekuar!

Vijm nga Vlora, Labëria,
Nga e jona Shqipëria.
Mirë se ju gjejmë me radhë,
Ju vëllezër mërgimtarë.


Këtu bashk me mëmëdhenë,
Me kryetrim Skënderbenë.
Mbledhur bashkë në shoqatë,
Këngë bukur, fjalë zjarrtë.



Sejmen GJOKOLI,
Drejtor i Folk Grup "Bilbili"



 **Miranda Hashani** 
En ligne il y a 1 h  

Kënaqësi që në nëntorin 2015 për Festën e Flamurit organizuar nga "Komuniteti Shqiptar i Gjenezës" munda të krijoj një atmosferë të shkëlqyer me këngët më të bukura shqiptare. Për një mikpritje të paparë e kujdes të

veçantë ashtu siç e kemi traditë në shqiptarët kudo që ndodhemi e gjeta edhe mes jush. Kënduam e vallëzuam bashk me flamurin tonë kuq e zi e me kostume tradicionale tregon që në këtë komunitet ruhet vlera kombëtare. Uroj që tradita të vazhdojë.



 **Malësor Prënkoçaj**
À moi 

De: **Malësor Prënkoçaj** <malesorima>
à: KomShqip-ComAlb - Geneve <cageneve@gmail.com>
Date: 20 sept. 2023 12:01
Objet: Re:
Envoyé par: hotmail.com
signé par: hotmail.com
sécurité:  Chiffrement standard (TLS) [En savoir plus](#)
 Ce message est important, en particulier parce qu'il vous a été directement envoyé.

Komuniteti Shqiptar i Gjenezës është një familje e njerëzve: të mirë, atdhetarë, humanistë dhe punëtorë të pa lodhshëm të çështjes kombëtare. Misioni i tyre i shenjtë, për ruajtjen dhe kultivimin e shqipes dhe për bashkimin e zemrave shqiptare për të mirën e shqipeve në vendin mik të shqiptarëve, Zvicër, si dhe në atdhe, tregon dashurinë e madhe për vendlindje dhe zemërbardhësinë e tyre që bazohet te amaneti dhe sakrifica e brezave për atdhe. Bashkëpunimi dhe afërsia që e kanë këta shqiptarë të mirë mes veti duhet të jetë model për të gjithë shqiptarët, si në diasporë ashtu edhe në atdhe.

Jam i nderuar që kam marrë pjesë në organizimet e kësaj shoqate, ku kam kalua çaste tepër të bukura, mes motrave e vëllezërve shqiptarë nga vendet e ndryshme të atdheut tonë.

Urime nga zemra dhjetëvjetorin e themelimit. Mos ua ndalët Zoti kurrë vullnetin për të kontribuar siç keni bërë deri më tani. Uroj që gjeneratat e ardhshme të kanë zemërbardhësinë e shpirtgjërësinë tuaj.

Me nderime të veçanta, vëllai juaj Malësor Prënkoçaj - Malësori.



S T A T U T I I KOMUNITETIT SHQIPTAR TË GJENEVËS

Gjenevë, 14 prill 2013



I. EMËRTIMI, SELIA DHE KOHËZGJATJA

Neni 1

Komuniteti Shqiptar i Gjenezës (në tekstin e mëtejshëm KShGj) është shoqatë, veprimtaria e së cilës është e bazuar në nenin 60 dhe në vijim, të Kodit Civil të Zvicrës dhe në këtë Statut.

Neni 2

Selia e KShGj-së është e vendosur në kantonin e Gjenezës dhe adresa e saj postare është e përcaktuar nga kryesia e KShGj-së.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së KShGj-së është e pakufizuar.

II. QËLLIMI I KRIJIMIT

Neni 4

Komuniteti Shqiptar i Gjenezës ka për synim:

1. Që brenda vetës të bashkoj shqiptarët që duan vullnetshëm të bashkohen, sidomos ata që jetojnë në Gjenezë dhe në rrethinën e saj, duke përfshirë edhe pjesën franceze;
2. Zhvillimin dhe përforsimin e ndjenjës së vëllazërimit, solidaritetit dhe ndihmës reciproke ndërmjet anëtarëve të vet, pavarësisht se nga cili regjion i trojeve shqiptare vijnë, sepse ne kemi një të kaluar dhe një të tashme shumë të ngjashme që shprehet fuqishëm në preokupimet tona, në jetën tonë;
3. Integrimin sa më efikas të komunitetit shqiptar të Gjenezës në shoqërinë zvicerane duke:
 - a) Inkurajuar mësimin e gjuhës shqipe nga fëmijët,
 - b) Inkurajuar mësimin e gjuhës frënge nga të rriturit,
 - c) Inkurajuar vazhdimin e shkollimit në nivele sekondare dhe terciare,
 - d) Ndhimuar shoqëritë kulturore dhe artistike që punojnë në ruajtjen e veçorive shqiptare, por që njëkohësisht bashkëpunojnë me shoqata të ngjashme të komuniteteve tjera duke e begatuar shumëllojshmërinë kulturore të Gjenezës,
 - e) Ndhimuar aktivitetet sportive të klubeve ku shumicën e përbëjnë shqiptarët dhe duke
 - f) Luftuar dukuritë ksenofobe;
4. Të shndërrohet në një vend ku çdo familje apo individ i komunitetit tonë do të gjen:
 - a) Informacione dhe udhëzime të sakta dhe të paanshme për preokupimet e veta siç janë puna, shkollimi i fëmijëve, realizimi i të drejtave dhe obligimeve ligjore ndaj shtetit ku jetojmë apo atij të origjinës, sikurse edhe shumë informacione tjera, dhe
 - b) Shërbime profesionale të të gjitha llojeve, me çmim të viltshëm;
5. Përkrahjen materiale për anëtarët e vet në rast nevojë, sikurse edhe, në raste të veçanta, përkrahjen materiale për bashkatdhetarët tanë në atdhe;
6. Ndërlidhjen e bizneseve me pronarë shqiptarë, me qëllim të rritjes së fitimeve dhe
7. Të zhvilloj dhe përforcoj bashkëpunimin ndërmjet KShGj-ës me komunitete tjera shqiptare dhe jo shqiptare, anëmbanë Zvicrës dhe më gjerë;

Neni 5

KShGj është shoqatë jofitimprurëse, jopolitike, jofetare dhe pa dallime krahinore.

Edhe pse jopolitike, në raste të ndryshme kur kërkohet deklarimi i qytetarëve në nivel komunal, kantonal apo federal, KShGj-ja mund të pozicionohet rreth një çështjeje, në pajtim me interesat e saj.

III. TË ARDHURAT

Neni 6

Të ardhurat e KShGj-së grumbullohen nga:

- a) Anëtarësia e anëtarëve,
- b) Subvencionet publike dhe/ose private,

- c) Aktivitetet e organizuara nga KShGj-ja,
- d) Donacionet e ndryshme dhe
- e) Të gjitha burimet tjera të autorizuar me ligj.

Është e ndaluar që cilido anëtar i KShGj-ës të kërkon para në dorë nga kushdo në emër të ndihmave për KShGj-ën, apo në emër të anëtarësisë. Të gjitha mjetet financiare duhet të kalojnë nëpërmjet xhiron llogarisë dhe të shfrytëzohen në pajtim me synimet dhe nevojat e KShGj-së.

IV. ANËTARËSIA

Neni 7

Anëtarët e KShGj-ës mund të janë:

- a) Anëtarë aktiv. Anëtarë aktiv janë ata që paguajnë anëtarësi, që marrin pjesë në organizime të ndryshme dhe si të tillë kanë drejt vote;
- b) Anëtarë nderi. Anëtarë nderi mund të janë ata persona që gjatë veprimtarisë së tyre, të tashme dhe të mëhershme, kanë treguar se janë të përkushtuar ndaj qëllimeve të KShGj-ës. Këta anëtarë nuk paguajnë anëtarësi dhe nuk kanë drejt vote. Pavarësisht këtij fakti, ata japin mendime dhe këshilla që nuk duhet anashkaluar.

Neni 8

- a) Anëtar aktiv i KShGj-ës mund të jetë çdo person që pranon dhe zbaton Statutin e KShGj-ës, që paguan anëtarësinë vjetore dhe që nuk është i punësuar në KShGj. Pranimi i Statutit nënkuptohet në momentin e plotësimit dhe të nënshkrimit të fletanëtarësisë.
- b) Anëtar nderi mund të bëhet personi i propozuar nga një apo më shumë anëtarë të KShGj-ës, në arsyetim të shkruar dhe nënshkruar, por i votuar me vota të fshehta nga kuvendi, me shumicë të thjesht votash. Nga propozimi gjer te votimi ai mbetet kandidat për anëtarë nderi.

Neni 9

Çdo anëtar i KShGj-ës, përveç obligimeve tjera të parapara me këtë Statut, ka për obligim të punoj me përkushtim edhe në masivizimin e KShGj-ës

Neni 10

Cilësia e anëtarit humbet në rast :

- të kërkesës me shkrim të paraqitur nga vet anëtari, drejtuar kryesisë së KShGj-ës,
- të pezullimit nga ana e kryesisë së KShGj-ës për shkaqe të arsyeshme, si për shembull në rast të shkaktimit të dëmit serioz material ose jo material ndaj KShGj-ës. I pezulluari ka drejtë ankese para kuvendit në afat prej 30 ditësh. Kuvendi bie vendim përfundimtar për përjashtim ose rikthim në KShGj,
- të mos pagesës së anëtarësisë për më shumë se 12 muaj,
- të vdekjes së anëtarit.

Anëtarët që kanë humbur cilësinë e anëtarit të KShGj-ës nuk gëzojnë asnjë të drejtë në të mirat materiale të KShGj-ës.

Neni 11

Në rast të vdekjes së një anëtari aktiv, bashkëshortja/i e/i tij/saj apo një nga fëmijët në moshë madhore, me kërkesën e tyre, trashëgojnë të drejtën e anëtarit aktiv.

Neni 12

Anëtarët aktiv apo të nderit të KShGj-ës nuk janë personalisht përgjegjës me pasurinë e tyre ndaj obligimeve të krijuara nga KShGj.

V. ORGANET E KShGj-së DHE FUNKSIONIMI

Neni 13

Organet e KShGj-ës janë:

- a) Kuvendi
- b) Kryesia dhe

- c) Organi i kontrollit të kontos

V.1. Kuvendi

Neni 14

Kuvendi është organi më i lartë i KShGj-ës dhe është i përbërë nga të gjithë anëtarët aktiv të KShGj-ës. Kuvendi bie vendime të rëndësishme siç janë:

- a) Modifikimi i Statutit,
- b) Aprovimi i rregulloreve të ndryshme,
- c) Zgjedh kryetarin e KShGj-ës,
- d) Zgjedh dhe shkarkon anëtarët e kryesisë së KShGj-ës dhe anëtarët e organit të kontrollit të kontos,
- e) Vendos mbi ankesat e anëtarëve ndaj vendimeve të kryesisë së KShGj-ës,
- f) Miraton raportet vjetore të punës dhe ato financiare,
- g) Vendos mbi lartësinë e anëtarësisë,
- h) Vendos mbi shpërbërjen e KShGj-ës,
- i) Përcakton shoqatat që kanë të drejtë të delegojnë nga një anëtar në kryesi të KShGj.

Neni 15

Kuvendi mbledhet njëherë në vit në sesion të rregullt. Sipas nevojës mund të mbledhet edhe më shpesh në sesione të jashtëzakonshme. Kuvendi mbledhet për sesion zgjedhor njëherë në dy vjet për të zgjedhur kryetarin dhe anëtarët e kryesisë. Në të gjitha rastet ai thirret nga kryesia ose me kërkesë të nënshkruar nga 1/5ta e anëtarëve aktiv, dhe me rend dite të bashkangjitur.

Ftesat për pjesëmarrje në kuvend, i dërgohen anëtarëve aktiv dhe të nderit më së paku 20 ditë përpara mbajtjes së kuvendit, në formë të shkruar, me dërgesë postare ose postë elektronike, dhe me rend dite të bashkangjitur.

Neni 16

Rendi i ditës për një kuvend të rregullt duhet të përmbaj domosdoshmërisht këto pika:

- a) Aprovimi i procesverbalit nga kuvendi paraparak,
- b) Paraqitja e raportit të punës për periudhën ndërmjet dy kuvendeve
- c) Paraqitja e raportit financiar në formë të qartë rreth prejardhjes së të hyrave dhe shpenzimeve dhe aprovimi i raportit,
- d) Paraqitja e raportit të verifikuesve të kontos,
- e) Aprovimi i raporteve të punës dhe atij financiar,
- f) Përcaktimi i lartësisë së anëtarësisë,
- g) Përcaktimi i shoqatave të cilat e kanë të drejtën të delegojnë nga një anëtar në kryesinë e KShGj-ës.
- h) Të ndryshme.

Neni 17

Kuvendi mbahet pavarësisht nga numri i anëtarëve të pranishëm. Mbledhjet e kuvendit kryesohen nga kryetari i KShGj-ës ose nga ndonjë anëtar i kryesisë.

Kuvendi nxjerr vendime të plotfuqishme me shumicë të thjeshtë votash (50% + 1 votë), nga numri i anëtarëve aktiv të pranishëm. Çdo anëtar aktiv ka një votë. Në rast të numrit të barabartë të votave, vota e kryesuesit vlen dyfish.

Neni 18

Në kuvend votohet me ngritje të dorës, kurse me vota të fshehta votohet në raste kur:

- a) këtë e kërkojnë më së paku 5 anëtarë të pranishëm në kuvend;
- b) kur votohet për rastin e paraparë në nenin 8, pika b) dhe
- c) kur votohet për kryetar dhe për anëtarë të kryesisë.

Një anëtar aktiv mund të privohet nga e drejta e votës, nëse vendimi përkatës ka të bëjë me atë personalisht, apo me ndonjë anëtarë tjetër me të cilin është në lidhje farefisnore, siç janë: bashkëshort, prind, fëmijë, vëlla, motër, nip, gjysh, gjyshe, xhaxha, dajë, hallë dhe teze.

V.2. Kryesia

Neni 19

Kryesia e KShGj-ës është organ ekzekutiv i KShGj-ës. Ajo kryesohet nga kryetari, kurse në mungesë të tij nga sekretari, respektivisht nga arkëtari.

Kryesia ka më së paku 9 anëtarë. Ata duhet të pasqyrojnë, sa më mirë që të jetë e mundur, heterogjenitetin e komunitetit tonë.

Kryesia e KShGj-ës është e autorizuar të ndërmarrë të gjitha veprimet që janë në pajtim me qëllimet e krijimit të KShGj-ës. Ndër detyrat e ndryshme që mund të paraqiten, kryesia ka edhe këto detyra:

- a) Përfaqëson KShGj-ën në raport me të tjerët,
- b) Thërret dhe përgatit materialet për kuvendit,
- c) Paraqet raportet vjetore para kuvendit,
- d) Kujdeset për zbatimin e Statutit të KShGj-ës,
- e) Emëron së paku sekretarin dhe arkëtarin, por mund të krijoj edhe poste tjera eventuale për të rritur efikasitetin e punës së kryesisë,
- f) Mban regjistrin e anëtarëve aktiv,
- g) Në rast nevojë propozon ndryshime në Statut dhe bie rregullore të ndryshme,
- h) Administron me të ardhurat e KShGj-ës,
- i) Bie vendime për angazhim të përkohshëm të ekspertëve nga lëmi të ndryshme, për realizimin e ndonjë projekti konkret,
- j) Pranon dorëheqjet me shkrim të anëtarëve të KShGj-ës dhe vendos mbi ankesat e anëtarëve të KShGj-ës, të bëra sipas nenit 10 të këtij statuti,
- k) Bie vendime mbi zëvendësimin e anëtarëve të kryesisë sipas nenit 20, duke përfshirë edhe ata të deleguar, sipas nenit 22 të këtij statuti, dhe
- l) Propozon anëtarët e merituar të KShGj-ës për mirënjohje.

Neni 20

Anëtarët e kryesisë janë të obliguar të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e kryesisë. Nëse pa ndonjë arsye ose pa e informuar kryetarin nuk vijnë tre herë rresht në mbledhje, do të zëvendësohen nga kandidati i pazgjedhur me më së shumti vota, sipas nenit 23, paragrafi 2, të këtij Statuti.

Neni 21

Kryesia mbledhet sa herë që ka nevojë me ftesë të kryetarit, apo me kërkesë me shkrim të drejtuar kryetarit dhe të nënshkruar nga 1/5-a e anëtarëve të kryesisë dhe me rend dite të përcaktuar. Kur 1/5 jep një numër decimal, ai rrumbullakohet në numrin e parë më të madh.

Kryesia bie vendime të plotfuqishme me shumicë të thjesht votash nga numri i anëtarëve të pranishëm. Në rast të numrit të barabartë të votave, vota e kryesuesit vlen dyfish. Çdo vendim shënohet në procesverbal që duhet të nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari.

Të punësuarit në KShGj mund të marrin pjesë në mbledhjet e kryesisë me ftesë të kryesisë, por nuk kanë drejtë vote. Anëtarët e nderit mund të marrin pjesë edhe pa ftesë, por as ata nuk kanë drejtë vote.

Neni 22

Shoqatat e përcaktuar nga kuvendi, sipas nenit 16 pika g), kanë të drejtë të delegojnë nga një përfaqësues në kryesinë e KShGj-ës me të drejta të plota. Personat e emëruar nga këto shoqata, duhet të janë anëtarë aktiv të KShGj-ës dhe të plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me këtë statut, për të qenë anëtarë të kryesisë. Delegimi i tyre bëhet me shkrim, sikurse edhe zëvendësimi me anëtarë të rinj.

Në momentin e themelimit të KShGj-ës këtë të drejtë e gëzojnë këto shoqata: Lidhja e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptar, Universiteti Popullor Shqiptar, Rinia Kontakt, ansambli "Gëzuar", Qendra Islame Kulturore Shqiptare "Dituria", Shoqata e Studentëve Shqiptar në Gjenevë, shoqata "Vitia", Rrethi Shqiptar-Mejrinas dhe Klubi Futbollit "Kosova".

Neni 23

Përveç anëtarëve të deleguar, të gjithë anëtarët tjerë të kryesisë zgjidhen nga kuvendi, nga radha e anëtarëve aktiv, me mandat dyvjeçar.

Anëtarët e kryesisë që zgjidhen nga kuvendi, zgjidhen me vota të fshehta, nga një listë që ka më së paku 3 kandidatë më shumë se sa duhet zgjedhur. Në rast se, për çfarëdo arsye,

ndonjë vend në kryesi mbetet bosh, ai plotësohet nga një kandidat i pazgjedhur që ka pasur më së shumti vota.

Neni 24

Anëtarë të kryesisë mund të janë vetëm ata persona që kanë shtetësi zvicerane, që kanë leje të përhershme qëndrimi në Zvicër (viza C ose B), ose që kanë shtetësi të ndonjë vendi të bashkimit evropian.

Për kryetar të KShGj-së mund të zgjidhet vetëm ai që ka qenë më së paku një mandat anëtar i kryesisë së KShGj.

Neni 25

Anëtarët e kryesisë nuk mund të janë në lidhje të afërt farefisnore mes veti, siç janë: fëmijë, prind, bashkëshort, vëlla, motër.

Për anëtarë të kryesisë nuk mund të zgjidhen ata anëtarë të KShGj-ës të cilët kanë çfarëdo funksioni në cilëndo parti politike, apo janë deputet të cilëndo parti në cilëndo vend dhe cilëndo nivel të pushtetit.

Kryetari i KShGj-ës nuk mund ta ushtroj këtë funksion pa ndërprerje, më shumë se në dy mandate të njëpasnjëshme.

Neni 26

Anëtarët e kryesisë janë vullnetarë dhe nuk mund të paguhen për punën e tyre. Ata mund të kompensohen për harxhimet e tyre faktike, në bazë të faturave të prezantuara. Me vendim të kryesisë, për aktivitetet që tejkalojnë punët e zakonshme, cilëndo anëtar i kryesisë po ashtu mund të kompensohet.

Neni 27

Në momentin e themelimit të KShGj-ës, për mandatin e parë, nuk është e domosdoshme që të respektohen domosdoshmërisht të gjitha procedurat e parapara me këtë statut, për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të kryesisë.

V.3. Organ i kontrollit të kontos

Neni 28

Organi i kontrollit të kontos është i përbërë nga më së paku 3 anëtarë, që caktohen çdo vit nga kuvendi. Ata mund të mos janë fare anëtarë të KShGj-ës. Ata kontrollojnë aktivitetet financiare të KShGj-ës dhe paraqesin raportin vjetor para kuvendit, i cili këtë raport e aprovon ose refuzon.

Organi i kontrollit duhet të ketë qasje në të gjitha dokumentet dhe të dhënat nga kontabiliteti që mundësojnë kontrollin e detajuar.

Viti financiar përputhet me vitin kalendarik.

Neni 29

Të gjitha veprimet bankare të KShGj-ës bëhen me nënshkrime kolektive, së paku me dy nga tre sosh, që nënkuptojnë nënshkrimet e kryetarit, sekretarit dhe arkëtarit.

Transparenca dhe qasja ndaj raporteve mujore nga xhiro-llogaria është e garantuar, në çdo kohë dhe për çdo anëtarë të KShGj-ës.

Neni 30

Përgjegjësia e KShGj-ës është e kufizuar në mjetet e saja.

VI. DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 31

Për shpërbërjen e KShGj-ës mund të vendoset vetëm në një kuvend të thirrur enkas

për këtë qëllim. Vendimi bëhet i plotfuqishëm nëse për të votojnë 2/3tat e anëtarëve aktiv nga numri i anëtarëve aktiv të pranishëm. Në të njëjtin kuvend duhet të emërohen dy ekzekutues të vendimit që do ndërmarrin veprimet e duhura.

Neni 32


Në rast të shpërbërjes së KShGj-ës, mjetet me të cilat disponon KShGj i kalohen një shoqate tjetër me qëllime të ngjashme ose ndonjë institucioni me interes publik. Në asnjë rast këto mjete nuk mund t'i kthehen anëtarëve të KShGj-ës, as në tërësi, as pjesërisht.

Neni 33

Ky Statut është miratuar në Kuvendin Themelues të KShGj-ës, të mbajtur me datë 14 prill 2013 në Gjenevë.


Kryetari

Ali Mehmeti



Sekretari

Ajet Hyseni



Arkëtari

Nexhmedin Hazi



Ndryshimet dhe plotësimet :

1. Në Kuvendin e pestë, në vitin 2017, është bërë ndryshimi i Nenit 5 në mënyrë që në të dy paragrafët fshihet fjala "jopolitike" dhe zëvendësohet me fjalën "jopartiake".

Në Gjenevë, më 5 maj 2017


Kryetari

Afërdita Krasniqi



Sekretari

Ali Mehmeti



Arkëtari

Nasuf Nuhiu

